

RAPORT VJETOR | 2022

AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)



Adresa: Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë.
Tel:+355 (0) 42251001, www.aida.gov.al | e-mail: info@aida.gov.al

RAPORTI VJETOR 2022

1

Profili i AIDA-s

2

AIDA në ushtrim të funksioneve të veta

3

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

4

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë

5

Drejtoria e Koordinimit

6

Drejtoria e Shërbimeve Mështetëse

1 PROFILI I AIDA-S

1.1 Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

1.2 Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqëndrohet, kryesisht, në:

- Lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- Rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- Nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- Nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.


Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

1.3 Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 2, datë 04.01.2011, të ndryshuar me vendimin nr. 1, datë 25.03.2019,
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 11, datë 21.07.2011;
- Vendimit nr. 3, datë 17.06.2019 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Aktualisht, AIDA strukturohet në pesë drejtori:



1.4 Organigrama



Drejtorja e Investimeve ka këto funksione:

- Asiston dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime;
- Ofron shërbimin e përkujdesjes dhe mbështetjes së investitorëve ekzistues ose potencialë;
- Asiston dhe mbështet me procedura të përshpejtuara investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

Drejtorja e NVM dhe Projekte ka këto funksione:

- Të rrisë aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare për zhvillimin e tyre;
- Të jetë në shërbim të sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore siç është dhënia e granteve të shtetit shqiptar apo identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, lehtësimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare etj, mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë.

Drejtorja Marketing & Kërkim Analizë ka këto funksione:

- Sigurimin e komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikat, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj.;
- Kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Drejtorja e Koordinimit ka këto funksione:

- Mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s;
- Matjen dhe vlerësimin e rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve.

Drejtorja e Koordinimit ka këto funksione:

- Të mbështesë veprimtarinë e Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin e veprimtarisë normale të proceseve të punës;
- Të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrativ të institucionit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2 AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

2.1 Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

Informacione mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht.

Kontakte nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misionëve specifike të kontaktit për të përmbushur nevojat e investorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim.

Këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve dhe metodave të financimit.

Ndihmë për investorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDA-s.

Mbështetje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale

2.2 Investimet

2.2.1. Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD)


2.2.1.1. Krahësim i vitit 2021 – 2022 në terma të fluksit dhe stokut të IHD-ve

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i IHD-ve në terma të fluksit, vijon si më poshtë:

VITI	2017	2018	2019	2020	2021	2022
FLUKSI (mln EURO)	899	1020	1073	937	1035	1372

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

Për vitin 2022, indikator i **fluksit** shënon vlerën **€ 1372 milionë**, duke shënuar shifër rekord në fluksin e investimeve të huaja direkte në vend. Krahësuar me vitin 2021, kur fluksi shënonte **€ 1035 milionë**, kemi **një rritje me € 337 milionë** ose me **32.5%**.



Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

2.2.1.2 Fluksi dhe stoku i IHD-ve sipas shteteve [1]

- Fluksi sipas shteteve

Për 2022, investimet e huaja në vend janë dominuar nga **Hollanda** e cila ka kontribuar me rreth **16%** në fluksin total, e ndjekur nga **Italia** me **10%**, **Gjermania** me **6.6%**, **Austria** me **6%** dhe **Kosova** me **4.6%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2022 sipas shteteve kryesore:

[1] 476 milionë Euro i përkasin 'Të tjera për arsye konfidencialiteti'

SHTETI	VLERA E FLUKSIT 2022 (mln EURO)
Hollandë	219
Itali	136
Gjermani	91
Austri	82
Kosovë	63
Turqi	58
SHBA	49
Francë	48
Zvicër	33

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

- Stoku sipas shteteve

Për 2022, investimet e huaja në vend janë dominuar nga **Zvicra** e cila ka kontribuar me rreth **16.6 %** në stokun total, e ndjekur nga Holanda me **16.4%**, **Kanadaja** me **12.7%**, **Italia** me **10.6%** dhe **Turqia** me **7.4%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2022 sipas shteteve kryesore:

SHTETI	VLERA E STOKUT 2022 (mln EURO)
Zvicër	1891
Hollandë	1866
Kanada	1450
Itali	1202
Turqi	844
Bullgari	716
Austri	710
Francë	445
Gjermani	311

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

2.2.1.3 Fluksi dhe stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2022

- Fluksi sipas aktivitetit ekonomik

Për 2022, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i **Fluksi sipas aktivitetit ekonomik**. Për 2022, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i **Aktiviteve të pasurive të paluajtshme** që përfaqësonte rreth 21.2% të fluksit total.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i **Industrië nxjerrëse** me 19.5%, i **Energjisë elektrike, gazit, dhe furnizimit me ujë** me 12.7%, i **Aktiviteve financiare dhe të sigurimit** me 11.5% dhe ai i **Industrië përpunuese** me 10.6% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2022 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E STOKUT 2022 (mln EURO)
Aktivite të pasurive të paluajtshme	291
Industria nxjerrëse	268
Energjia elektrike, gazit, dhe furnizimi me ujë	175
Aktivite financiare dhe sigurimit	158
Industria përpunuese	146

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

- Stoku sipas aktivitetit ekonomik

Për 2022, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të stokut ishte **Energjia elektrike, gazit, dhe furnizimi me ajër të kondicionuar** që përfaqësonte 26.5 % të stokut total.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i **Industrië nxjerrëse** me 15.3%, **Aktiviteve financiare dhe të sigurimit** me 12%, i **Informacionit dhe Komunikacionit** me 10.6% dhe i **Aktiviteve të pasurive të paluajtshme** me 10% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2022 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E STOKUT 2022 (mln EURO)
Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë	3,009
Industria nxjerrëse	1,746
Aktivitetet financiare dhe sigurimit	1,370
Informacioni dhe komunikimi	1,208
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	1,123

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

2.2.4. Tregtia e Jashtme

2.2.4.1. Të dhënat mbi importet

Importet për vitin 2022 shënojnë vlerën e 8,123 milionë EURO, me një rritje të konsiderueshme prej 22.7% nga viti paraardhës. I njëjti tregues, për vitin 2021, arrin vlerën e 6,618 milionë EURO.

Peshën më të madhe në këtë indikator për vitin 2022 e përbën grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 19.6% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 18% si edhe nga 'Ushqim, pije, duhan' me 15.7%.

Lidhur me përbërjen e strukturës së importeve në 2021, peshën kryesore e ka pasur grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 21.2% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Ushqim, pije, duhan' me 16.2 % si edhe nga 'Produkte kimike dhe plastike' me 14.3%.

GRUPMALLI	Janar - Dhjetor 2021 (mln EURO)	Janar - Dhjetor 2022 (mln EURO)
Ushqim, pije, duhan	1075	1275
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	869	1467
Produkte kimike dhe plastike	948	1000
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	123	145

Prodhime druri dhe letre	239	301
Tekstile dhe këpucë	751	870
Materiale ndërtimi dhe metale	924	1172
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1406	1598
Të tjera	284	293
TOTALI	6618	8123

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për vitin 2022, shtetet prej të cilave Shqipëria ka importuar më së shumti, janë si më poshtë vijon:

SHTETI	Vlera (mln EURO)	% ndaj totalit
Itali	1760	21.6
Turqi	980	12
Kinë	662	8.1
Greqi	636	7.8
Gjermani	501	6.1

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Italia zë peshën kryesore me 21.6% ndaj totalit duke u kthyer në një shtet dominant për importet e vendit tonë. Shtete të tjera me ndikim të lartë në këtë indikator janë Turqia, Kina, Greqia dhe Gjermania.

2.2.4.2. Të dhëna mbi eksportet

Eksportet për vitin 2022 shënojnë vlerën e *4,161 milionë EURO*, me një rritje të ndjeshme prej 36.5% nga viti paraardhës. I njëjti tregues, për vitin 2021, arrin vlerën e *3,048 milionë Euro*.

Peshën më të madhe në këtë indikator e përbën grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 27.7% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.' dhe 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 22% dhe 21.6% respektivisht.

Lidhur me përbërjen e strukturës së eksporteve, në vitin 2021 peshën kryesore e ka pasur po grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 37.6% ndaj totalit. Më pas renditej grupmali 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 15.4% dhe 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 14.7%.

GRUPMALLI	Janar - Dhjetor 2021 (mln EURO)	Janar - Dhjetor 2022 (mln EURO)
Ushqim, pije, duhan	368	442
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	573	919
Produkte kimike dhe plastike	88	151
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	18	25
Prodhime druri dhe letre	84	122
Tekstile dhe këpucë	929	1156
Materiale ndërtimi dhe metale	662	901
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	239	339
Të tjera	81	107
TOTALI	3048	4161

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për vitin 2022, shtetet në të cilat Shqipëria ka eksportuar më së shumti, janë si më poshtë vijon:


SHTETI	Vlera (mln EURO)	% ndaj totalit
Itali	1799	43.2
Kosovë	323	7.7
Gjermani	273	6.5
Greqi	216	5.2
Spanjë	200	4.7

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Italia zë peshën kryesore me 43.2% ndaj totalit të eksporteve duke u kthyer në një shtet dominant edhe në eksportet e vendit tonë. Shtete të tjera me ndikim të lartë në këtë indikator janë Kosova, Gjermania, Greqia dhe Spanja.

2.2.5. Prezenca e kompanive të huaja në Shqipëri

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri më 6 Janar 2023, në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë regjistruar **22 436 kompani me kapital 100% të huaj/të përbashkët**, prej të cilave rreth **66% ose 14 801 kompani janë aktive**. Pjesa tjetër prej **7 635 kompani ose 34%**, kanë një status **jo aktiv**: pasiv, çregjistruar, falimentuar, pezulluar, shoqëri në likuidim e sipër apo shoqëri në procedurë falimenti.




■ Aktive ■ Jo Aktive

Burimi: QKB, përpunuar nga autori

2.2.5.1. Shpërndarja e kompanive sipas pronësisë

Ndër 14 801 kompani aktive, **80.5%** ose **11 923** prej tyre kanë **kapital 100 % të huaj**, ndërsa pjesa tjetër prej 2 878 kompanish ose **19.5%** janë me **kapital të përbashkët (shqiptare + e huaj)**.



■ Kapital 100% i huaj ■ Kapital i përbashkët

Burimi: QKB, përpunuar nga autori

2.2.5.2. Shpërndarja e kompanive sipas qarqeve

Pjesa më e madhe e kompanive aktive operojnë në qarkun e **Tiranës**, përkatësisht **68%** ose **10 073 kompani**. Qarqe të tjera me prezencë të lartë të kompanive me kapital të huaj/të përbashkët janë ai i **Durrësit** dhe **Vlorës** përkatësisht me **13%** dhe **6.1%** ndaj totalit të kompanive aktive.

2.2.5.3. Shpërndarja e kompanive sipas origjinës së kapitalit

Ndër 14 801 subjekte aktive, vetëm **12 584** prej tyre kanë deklaruar informacion lidhur me origjinën e kapitalit, ndaj edhe analiza bëhet mbi këtë shifër.

Kompanitë me prezencë më të lartë në vendin tonë janë ato me origjinë italiane, me plot **5539 kompani** ose **44 %**. Kompani të tjera me prezencë të lartë janë ato me origjinë **kosovare (1198 subjekte)**, **greke (760 subjekte)** dhe **turke (710 subjekte)** me përkatësisht **9.5%**, **6 %** dhe **4.8%** ndaj totalit.

SHTETET DOMINUESE	NUMRI SUBJEKTEVE
Itali	5359
Kosovë	1198
Greqi	760
Turqi	710
Maqedonia e Veriut	429
Egjipt	345
Gjermani	325
SHBA	322
Rusi	237
Angli	206


Burimi: QKB, përpunuar nga autori

2.2.5.4. Shpërndarja e kompanive sipas aktivitetit ekonomik

Kompanitë me kapital të huaj/të përbashkët operojnë në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik. Fusha me prezencë më të lartë është ajo e **Shërbimeve** me **36%** ndaj totalit të kompanive. Kjo fushë ndiqet nga ajo e **Tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave**, me një diferencë prej **6%** duke rezultuar në **30%** ndaj totalit.


Fusha të tjera me prezencë të lartë të kompanive me kapital të huaj/të përbashkët janë ajo e **Industrisë përpunuese**, **Ndërtimit** dhe **Informacionit & Komunikacionit** me përkatësisht **12%**, **8%** dhe **8%** ndaj totalit.

Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve - 2020




Burimi: QKB, përpunuar nga autori

Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve - 2021



Burimi: QKB, përpunuar nga autori

Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve - 2022



Burimi: QKB, përpunuar nga autori


2.2.6. Tregu i Punës

2.2.6.1. Indikatorë të Tregut të Punës

Forca e punës gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë në rritje, ndërsa në 2020 ka paraqitur një rënie të lehtë e ndjerë nga efektet e pandemisë, të cilat vazhduan të ishin të pranishme dhe për vitin 2021.

Shifrat më të fundit për forcën e punës të T3 2022 shfaq një trend pozitiv për forcën e punës, e cila shënon 1477 mijë persona (me përfshirjen e shtresës inaktive), duke shënuar shifrën më të lartë të këtyre viteve.

Forca punëtore (në mijë)



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori


Niveli i punësimit ka qenë në një trend rritës në vitet 2017-2019. Në vitin 2019 niveli i punësimit arriti në 1266 mijë të punësuar, duke u rritur me 2,9% nga viti para-ardhës. Gjatë 2020, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 1,8% krahasuar me 2019 dhe të njëjtat nivele u ruajtën dhe për vitin 2021. Në tremujorin e katërt 2022, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 66,5 %. Gjatë këtij tremujori, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 4,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021, dhe u ul me 0,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2022.

Në tremujorin e katërt 2022, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 10,8 %. Shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,6 pikë përqindje, në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2021, dhe u rrit me 0,2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022.

2.2.6.2 Punësimi sipas statusit në punësim

Për vitin 2021, rezulton se 47,9 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,0 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 20,1 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. Niveli i të punësuarve me pagë ka ndryshuar me 8.6% krahasuar me vitin 2017.

Punësimi sipas statusit në punësim (në %)



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.2.6.3. Paga minimale

Paga minimale është nga ata indikatorë të tregut të punës me dy impakte direkte: është indikator që tërheq interesin e investitorëve të huaj, por njëkohësisht përcakton edhe standartin e investimit potencial të huaj.

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
PAGA MINIMALE	24000	24000	26000	26000	32000	34000

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.2.6.4. Paga mesatare

Në vitin 2021, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 57.191 lekë.

Për T4 2022 paga mesatare bruto është 66.014 lekë, duke u rritur me 10.8 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Paga mesatare bruto paraqet një trend në rritje si për sektorin privat, po ashtu edhe për atë shtetëror.

	2017	2018	2019	2020	2021	T4 2022
Paga mesatare mujore bruto	48967	50589	52380	53662	57191	66014
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror	59813	61023	63084	64330	68508	74450
Paga mesatare mujore në sektorin privat	44027	45759	47532	48620	51858	62198

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.2.7. Lead Generation and After Care

2.2.7.1 Gjenerimi i Leads, ndjekja dhe follow up i tyre

AIDA vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për investitorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase, etj.

Përgjatë vitit 2022 u arrit në total numri total prej 38 projekteve "Lead" në ndjekje nga AIDA (aktive dhe pasive), prej të cilave 4 janë projekte të materializuara. Shtetet e tyre të origjinës janë kryesisht Italia, Gjermania dhe Kina ndjekur nga kompani të tjera me origjinë hollandeze, turke, hungareze, amerikane dhe sllovaqe, të cilat kanë shprehur interesin për realizimin e investimeve në sektorë të ndryshëm në Shqipëri.

Duke mbajtur parasysh që jo të gjitha investimet potenciale kanë shprehur vlerën e investimit dhe punësimin që do të gjenerojnë, konstatohet se vlera totale e këtyre investimeve arrin përafërsisht vlerën prej 223.3 Milionë Euro, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve në këto aktivitete të jetë mbi 5410.

Për sa u përket fushave të aktivitetit të këtyre projekteve, interesi kryesor dhe më i madh ka qenë në sektorët e industrisë automotive, industrisë përpunuese dhe manifakturës, ndjekur nga sektorë të tjerë si: energjia e rinovueshme, bujqësia, turizmi, miniera, ndërtimi dhe BPO.

Në fund të vitit 2022 rezulton që nga të gjitha projektet “Lead”, 14 prej tyre vazhdojnë ende të ngelen aktive dhe do të ndiqen në hapat e mëtejshëm nga AIDA. Më konkretisht gjatë vitit 2022, AIDA ndoqi 4 “Leads” të rinj, të cilët së bashku arrijnë një vlerë investimi prej 128 Milionë Euro. Lead me zhvillimet më të mëdha ka qenë ai i kompanisë Nexans, kompani gjermane e cila synon hapjen e një fabrike në sektorin automotive me një vlerë investimi rreth 20 Milionë Euro.

2.2.7.2 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet.

AIDA është një aktor i rëndësishëm në implementimin në praktikë të BIDS dhe praktikave të parashikuara nga strategjia. Në tërësinë e saj “BIDS 2021 – 2027” përbëhet nga një qëllim strategjik kryesor që është “Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritetit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës”. Në këtë qëllim strategjik zenë vend po ashtu edhe objektiva specifike që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të zhvillimit të biznesit dhe investimeve të huaja, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me pandeminë e COVID-19 apo fushat e reja deri tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara në lidhje me biznesin (ndryshimet teknologjike, digjitalizimi, etj).

Në përmbushje të vizionit të BIDS 2021-2027 institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë, në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në tërheqjen e investimeve dhe ndërkombëtarizimin përmes masave përkatëse:

• Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi

Strategjia e re vendos theksin mbi rëndësinë strategjike të investimeve dhe integritetit nëzinxhirin e vlerave dhe tregjet ndërkombëtare për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm si dhe shpalosjen e plotë të potencialit investues për zhvillim ekonomik.

Masat:

1. Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara. Në kuadrin e BIDS, AIDA, përgjatë vitit 2022 realizoi fushatën e parë Outreach Campaign në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi. Fushata u realizua në përputhje të objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027, e cila parashikon kryerjen në total të 7 fushatave të promovimit përgjatë kohëzgjatjes të veprimit të strategjisë.
2. Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme
3. Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve.

2.2.7.3 Zhvillimi i fushatës Outreach në Turqi në sektorin e bujqësisë

Në periudhën gusht - shtator 2022, stafi i AIDA u angazhua në realizimin e Outreach Campaign në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi. Fokusi i kësaj fushate ishin më specifikisht kontaktimi dhe prezantimi i mundësive për investim në Shqipëri për kompanitë turke të cilat operojnë në prodhimin dhe përpunimin e domateve, frutave dhe bimëve aromatike dhe medicinale.

Fushata u realizua gjithashtu në përputhje të objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027, e cila parashikon kryerjen në total të 7 fushatave të promovimit përgjatë kohëzgjatjes të veprimit të strategjisë. Përzgjedhja e sektorit dhe shteti u krye duke konsideruar interesin e paraqitur nga kompanitë turke në sektorin e bujqësisë pranë AIDA-s, rëndësinë strategjike të sektorit si dhe afërsinë gjeografike dhe partneritetin e konsoliduar mes dy vendeve.

Gjithashtu, AIDA zotëron marrëdhënie të mira me agjencinë homologe turke, gjë që na ka mundësuar pasjen e një informacioni më konkret për potencialet reale në vend.

Fushata është realizuar duke u bashkërenduar me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ka zhvilluar takime të vazhdueshme me AIDA-n dhe ka asistuar me informacione për përgatitjen e propozimit të vlerës që do i prezantohej kompanive të përzgjedhura. Përgatitja e këtij propozimi u bë duke analizuar segmentet të cilët paraqesin potencialin më të madh në Shqipëri dhe segmentët në të cilët kompanitë turke paraqesin një avantazh kompetitiv.

Ekzekutimi praktik i kësaj fushate u realizua duke kryer takime me kompani të targetuara më parë dhe zbulimin e kompanive të reja, të cilat morën pjesë në panairin “CNR Food Istanbul- Food and Beverage Products, Food Processing Technologies Meeting”, një nga panairët kryesore për industrinë ushqimore në Turqi, i cili zhvillohej nga 31 gusht deri më 3 shtator 2022.

Ky panair u përzgjedh duke konsideruar rëndësinë e tij dhe pjesëmarrjen e lartë të kompanive dhe vizitorëve në vitet paraardhëse. Gjithashtu, përqëndrimi i kompanive të sektorit të synuar në të njëjtën hapësirë shërbeu për të lehtësuar kontaktin e drejtpërdrejtë me shumë kompani, duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e ekzekutimit të fushatës. Stafi i AIDA mori pjesë në panair në cilësinë e vizitorit, i angazhuar në kontaktimin e kompanive të targetuara paraprakisht, si dhe në gjetjen e kompanive të reja të përputhshme me sektorin dhe nënsektorët e targetuar.

2.2.7.4 Aftercare

Gjatë vitit 2022, Sektori Aftercare rivendosi kontaktet me një sërë kompanish të cilat ishin pjesë e databazës, në bashkitë Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Fier. Gjithashtu u organizuan takime me kompani të reja në funksion të krijimit të urave të komunikimit si dhe nxitjes së bashkëpunimit mes biznesit dhe AIDA-s. Në vitin që lamë pas janë zhvilluar në total 21 takime pranë kompanive me kapital të huaj, të përbashkët dhe vendas. Gjithashtu janë finalizuar me sukses 7 aktivitete asistence dhe 9 çështje vijojnë të jenë në ndjekje.

Edhe gjatë vitit 2022 AIDA ka vijuar të jetë pranë bizneseve, duke i asistuar hap pas hapi për problematikat e raportuara, në ndërlidhje me njësitë e qeverisjes vendore dhe qendrore, duke krijuar kështu mundësinë për një komunikim sa më efektiv mes subjekteve dhe enteve shtetërore, me qëllim lehtësimin dhe inkurajimin e riinvestimeve në vend.

2.2.7.4.1 Programi me qeverisjen lokale dhe bashkëpunimi me IFC/Bankën Botërore dhe GIZ

Që prej gati katër vitesh AIDA ka patur një rol proaktiv ndaj përfaqësuesve të investitorëve të huaj të pranishëm në Shqipëri. Për këtë qëllim pranë këtij institucioni vepron një organ i dedikuar për përkujdesjen ndaj investitorëve të huaj ose shqiptarë, që janë tashmë të vendosur në Shqipëri, duke i asistuar për çdo problematikë që mund të kenë gjatë zhvillimit të planit të tyre të biznesit, duke lehtësuar procedurat me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim krijimin e kushteve për riinvestime.

Plani i Veprimit vijoi me zbatimin për vitin 2022. AIDA së bashku me GIZ (ProSEED), me partner Zyrën e Kryeministrit, si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërmorrën një projekt të përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit After-Care dhe zgjerimin e bashkëpunimit me qeverisjen lokale, duke vendosur urat e komunikimit edhe me Bashkinë Kamëz. Qëllimi i kësaj iniciative është krijimi i një zinxhiri komunikimi mes AIDA-s, Bashkisë, Institucioneve të Edukimit & Kërkimit, si dhe investitorëve prezentë në zonë, duke synuar përmirësimin e bashkëpunimit mes tyre, përkrahjen e investimeve ekzistuese, nxitjen e riinvestimeve dhe promovimin e resurseve lokale. U përzgjedh Bashkia Kamëz për shkak të afërsisë që ka me kryeqytetin dhe pozicionit të saj të favorshëm për zhvillimin e biznesit, por gjithashtu edhe për shkak të numrit të madh të bizneseve të ndryshme që operojnë në këtë zonë, të cilat rrjedhimisht përkthehen edhe në numër të lartë të punësuarish. Faza e parë e projektit përfshiu vendosjen e bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz duke caktuar një focal point, pra një person kontakti, i cili do të jetë përgjegjës në vijimësi për mbarëvajtjen e bashkëpunimit midis AIDA-s dhe bashkisë, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Gjithashtu është realizuar një prezantim dhe trajnim i stafit të bashkisë nga AIDA mbi fokusin dhe rolin e sektorit After-Care.

Qëllimi nuk ka qenë vetëm prezantimi i stafit të bashkive me Shërbimin After-Care, por edhe lehtësimi apo ndërmjetësimi i raportit të kompanive me bashkitë për çështje që lidhen me aktivitetin e tyre.

Një hap tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe bashkëpunimi me shkollat profesionale.

Duke i konsideruar shkollat profesionale si element kyç në zhvillimin e biznesit, synimi i kësaj faze të punës ishte vendosja e urave të bashkëpunimit shkollat profesionale në zonën e Kamzës, duke pasur si qëllim përmirësimin e komunikimit mes tyre dhe biznesit, por edhe me qeverisjen lokale po ashtu.

Është realizuar takim me Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz. Takimi u zhvillua me praninë e stafit nga AIDA, ekspertit të caktuar nga GIZ dhe drejtuesit të shkollës. Përgjatë takimit janë shkëmbyer ide mbi përmirësimin e raportit të shkollës me bizneset që operojnë në atë zonë, si dhe u përcollën problematikat kryesore që shkolla ka hasur.

Për ngritjen e këtij zinxhiri komunikimi, në bashkëpunim me Bashkinë planifikohet që përgjatë 2023 të kryhen takime direkte me disa nga bizneset e huaja prezente në zonë. Synimi i takimeve do të jetë të kuptohet si është situata aktuale e kompanive në raport me krizat globale që po ndodhin, cilat janë planet e tyre të ardhshme të zhvillimit dhe si mundet Bashkia dhe AIDA të lehtësojë zhvillimin dhe ecurinë e tyre.

2.2.7.4.2 Plani i Veprimit Aftercare për vitin 2022

Në vazhden e aktiviteteve dhe takimeve që AIDA zhvillon pranë bizneseve me përfaqësues të bashkive të vendit si dhe në funksion të realizimit të fushatës Outreach në Turqi, me fokus sektorin e bujqësisë, gjatë vitit 2022 u realizuan takime me disa kompani të njohura që operojnë në këtë sektor. Këto takime vlenin për përgatitjen e një informacioni paraprak mbi situatën aktuale në bujqësi, problematikat potenciale dhe hapësirat ku mund të nevojitej investim i mëtejshëm. Gjithashtu gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 stafi i AIDA-s zhvilloi 9 takime pranë kompanive më të rëndësishme që operojnë në sektorin energjetik. Objektivi ishte fillimisht njohja me AIDA-n si institucioni përgjegjës për tërheqjen e investimeve të huaja në vend dhe diskutimi i problematikës së krizës ndërkombëtare energjetike dhe në ç'masë ka impaktuar bizneset.

Gjatë takimeve u diskutua mbi sfidat e investorëve të huaj në implementimin e projekteve të mëdha në energjinë e rinovueshme, të cilat u adresuan pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Vizitat konsistonin po ashtu në marrjen e një feedback-u sa i përket klimës së përgjithshme të investimeve në vend. Përmes një përzgjedhjeje, kompanitë pranë të cilave u organizuan vizitat ishin Voltalia (Karavasta Solar), SHELL Upstream, TAP, Statkraft (Devoll Hydropower), Ayen Energji AS, Novamat sh.p.k, FMT Servomatik, Recom Technologies dhe Eco Energia.

Voltalia (Karavasta Solar) është fituesi i parë i një ankandi në energjinë e rinovueshme në Shqipëri. TAP është projekti i shpërndarjes së gazit azer, i cili transporton 10 miliardë m³/vit gaz natyror dhe është në operim prej 2 vitesh. Kompania norvegjeze Statkraft (Devoll Hydropower) është e pranishme në Shqipëri, që prej vitit 2007 me projektet e Hidrocentralit të Banjës dhe Moglicës.

SHELL është investitori i huaj më i madh në vendin tonë në sektorin e industrisë nxjerrëse të naftës, prej 10 vitesh tashmë në Shqipëri. Kompania Ayen As Energji ndodhet në vendin tonë prej 35 vitesh me projektet në basenin e lumit Fan. Novamat sh.p.k është kompani shumëdimensionale, e cila operon mes të tjerash dhe në sektorin energjetik dhe është prezente në treg që prej vitit 2008.

FMT Servomatik është prodhues i stabilizatorëve të tensionit dhe paneleve diellore me 25 vjet eksperiencë në treg me produkte Made in Albania.

RECOM Technologies është kompani me kapital 100% francez, e cila prodhon module, qeliza, invertera, sisteme hibride magazinimi, bateri dhe karikues EV.

Eco Energia është një nga kompanitë e para në tregun shqiptar, e specializuar në projektimin, ndërtimin dhe punën e impianteve fotovoltaike.

Në këtë kuadër asistencë e AIDA-s përfshiu jo vetëm bizneset, por dhe shkollat profesionale, si një hallkë shumë e rëndësishme për punësimin e forcës punëtore në vend. Gjatë vitit 2022, u realizuan vizita pranë Shkollës së Mesme Profesionale Kamëz dhe Shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota" në Fier.

Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, nën statusin MFC (Multi-Functional Center), aktualisht ka rreth 1500 nxënës dhe ofron degë si: Teknologji informimi dhe komunikimi; Shërbim social shëndetësor; Hoteleri–turizëm; Shërbim mjetesh transporti; Bujqësi. Përgjatë takimit u shkëmbyen ide mbi përmirësimin e raportit të shkollës me bizneset që operojnë në atë zonë, si dhe u përcollën problematikat kryesore që shkolla ka hasur.

Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota", e cila është e vendosur në qytetin e Fierit, numëron rreth 650 nxënës që janë duke ndjekur studimet pranë saj në profile si: Shërbime mjetesh transporti; Elektro-teknikë; Mekanikë, Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK), etj. Takimi konsistoi në një prezantim të detajuar të rolit të AIDA-s dhe shkollës iu ofrua mbështetje dhe asistencë për të vendosur komunikim me biznese që operojnë në atë zonë me synimin për të krijuar një përjasje tjetër ku të përshtatet nevoja e tregut dhe e bizneseve me kurrikulat specifike që zhvillohen në shkollë.

2.2.7.5. Identifikimi i pronave me potencial për investime

Pronat shtetërore dhe zonat me përparësi zhvillimi

Bazuar në legjislacionin sektorial, propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi mund të bëhet nga ministritë e linjës, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe rregullave të funksionimit të zonave, të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave, me vendim të posaçëm.

Bazuar në VKM nr. 1023/2015, zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimi fokusohet, kryesisht, në:

- orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që të përfitohet nga specializimi i punëkërkesve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturave. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë rritjen e efikasitetit të infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim, si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;

- orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimin profesional, si dhe përmirësimin e infrastrukturave.

Gjatë vitit 2022, AIDA ka vazhduar të kryejë verifikime përkatëse për prona shtetërore të cilat kanë potencial për t'u konsideruar si zona me përparësi zhvillimi dhe rrjedhimisht si zona potenciale për tërheqjen e investimeve të huaja në vend.

Zonat në fjalë janë zona me potencial për krijimin e një poli ekonomik, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të bashkive përkatëse, çka do të mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme.

Shpallja e një zone me përparësi zhvillimi do të mundësojë rihzhvillimin dhe pasurimin e saj me funksione të ndryshme, duke ndikuar në rritjen ekonomike të zonës. Objektivi kryesor i shpalljes së një zone me përparësi zhvillimi, do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën dhe larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.

Pronat e identifikuar gjatë vitit 2020, vijnë të jenë potenciale për shfrytëzim nga investitorët vendas dhe të huaj, prona si :

- Ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan
- Aseti Uzina e Plehrave Azotike, Fier
- Aseti Fabrika e Duhan Cigareve, Shkodër
- Uzina e telave dhe e kabllove, Shkodër
- Ish Vaskat e Peshkut, Korçë

Prona private

Përgjatë vitit 2022, AIDA ka qenë gjithashtu e angazhuar në identifikimin e pronave private, të cilat mund t'ju paraqiten investitorëve potencialë me qëllim shtimin e opsioneve të tyre për të konkretizuar investimin në Shqipëri. Vlen të përmendet se disa nga pronat që janë konstatuar përgjatë vitit të kaluar janë propozuar ndaj investitorëve, të cilët janë angazhuar në procese negociatash me palët private.

Gjithashtu, AIDA u angazhua në një fushatë për identifikimin e pronave private, e cila u realizua nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale të AIDA, nëpërmjet një thirrje në të cilën u ftuan zotëruesit e pasurive të paluajtshme të japin të dhëna për pronën e tyre duke plotësuar një formular që iu bashkëlidh thirrjes së publikuar.

Nëpërmjet kesaj fushate synohet formimi i një databaze pronash private që do të mundësonte ndërtimin e urave të shpejta të komunikimit mes investitorëve dhe zotëruesve të pronave, ku agjencia jonë kryen një rol facilitues. Benefitet e menjëhershme të kësaj iniciative lidhen me zgjerimin e opsioneve që ofrohen ndaj investitorëve duke siguruar më shumë siguri për realizimin e investimit. Në vijim të thirrjes, 2 persona fizikë bashkëlidhën informacione mbi pronat e tyre, njëra prej të cilave me vendndodhje në njësinë administrative Petrelë dhe prona tjetër në Elbasan.

2.2.7.6 Iniciativa të Drejtorisë së Investimeve përgjatë 2022

2.2.7.6.1. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS)

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet.

Gjatë vitit 2022, AIDA ka qenë e përfshirë në detajimin e çështjeve të strategjisë të cilat janë të lidhura ngushtësisht me veprimtarinë e AIDA-s. Referuar objektivit të ndërkombëtarizimit të investimeve, fokusi i Agjencisë ka qenë në organizimin e fushatës outreach në sektorin e bujqësisë në Turqi, duke prezantuar potencialet e vendit në këtë sektor.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e strategjisë janë dhe shërbimet e përkujdesjes ndaj investitorëve ekzistues në Shqipëri, të cilat janë detajuar sa më sipër.

2.2.7.6.2 Bashkëpunimi me Zyrën e Investimeve të Presidencës Turke

Në kuadër të misionit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve mbi promovimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, në datat 30 – 31 maj, stafi i AIDA-s zhvilloi vizitë në Zyrën e Investimeve të Presidencës Turke.

Përgjatë vizitës, përfaqësues të Zyrës së Investimeve të Presidencës Turke në Stamboll dhe Ankara, realizuan disa prezantime lidhur me si më poshtë vijon:

- Misioni, funksionet dhe roli i Zyrës së Investimeve të Presidencës Turke;
- Struktura e Zyrës së Investimeve të Presidencës Turke;
- Promovimi i Investimeve të Turqisë – ndërtimi i imazhit;
- Promovimi i sektorëve specifikë – targetimi i investitorëve;
- Lehtësimi i Investimeve;
- Marketingu dhe mediat sociale.

Vizita vazhdoi me zhvillime të takimeve në nivel përfaqësuesish midis dy insitucioneve. Vëmendje të veçantë nga të dyja palët mori zhvillimi dhe menaxhimi i zonave të lira ekonomike. Sektorë të tjerë për të cilët u diskutua ishin: akuakultura, menaxhimi i porteve, bujqësia, turizmi etj.

Të dyja institucionet ndërtuan ura të përbashkëta bashkëpunimi për të hartuar në vijimësi propozime konkrete të investimeve në sektorët e identifikuar me interes.

2.2.7.7. Pjesëmarrja e AIDA në tryeza pune vendimarrëse

2.2.7.7.1 Multi-annual Plan for Regional Economic Area (MAP REA) dhe Common Regional Market (CRM)

Përgjatë vitit 2022 AIDA ka vazhduar të jetë një ndër aktorët e përfshirë në iniciativat e integritit rajonal. Puna e zhvilluar përgjatë viteve 2017-2020 me MAP REA do të vazhdojë të thellohet nëpërmjet Planit të Ri të veprimit CRM përgjatë viteve 2021-2024. Viti 2020 pa përmbylljen me sukses të planit të veprimit të MAP REA.

Për zbatimin e Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024, fokusi deri në këtë pikë ka qenë në mbledhjen e të dhënave për skemat e lehtësimit të investimeve dhe nxitjen e investimeve në nivel rajonal. Për këtë, Shqipëria ka ofruar:

- Të dhëna për skemat e stimulimit të investimeve të vendit në përputhje me modelin e miratuar bashkërisht nga të gjitha ekonomitë pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor.
- Ka dhënë kontributin dhe dakordësimin e saj për përzgjedhjen e tre sektorëve (automotiv, përpunimi i ushqimit dhe përpunimi i metaleve) që do të zgjidhen për nxitjen e investimeve rajonale, të cilat janë në përputhje me sektorët e propozuar në Shtyllën e Industrisë dhe Inovacionit.

Aktivitetet e tjera të kohëve të fundit në të cilat Shqipëria është përfshirë sipas Planit të Veprimit është krijimi i një "Programi Rajonal të Zhvillimit të Furnizuesve (RSDP)", i cili do të lehtësonte lidhjet e furnitorëve vendas dhe shumëkombësheve ndërmjet Ballkanit Perëndimor në sektorët e synuar/zinxhirët e furnizimit. Nisma është diskutuar dhe pranuar nga ekonomitë anëtare dhe aktualisht janë duke u planifikuar hapa konkretë për zbatimin e iniciativës.

2.2.7.7.2. Pjesëmarrjen në diskutimet për "Investment Facilitation for Development" nga OBT

Përgjatë 2022 AIDA, së bashku me MFE, ka qenë pjesë e diskutimeve për lehtësimin e investimeve për zhvillim nga OBT, të cilat po zhvillohen në sfondin e një marrëdhënieje në rritje dhe përforcuese midis tregtisë dhe investimeve, e cila ka potencialin për të nxitur rritjen ekonomike dhe diversifikimin, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në dhjetor 2017, 70 anëtarë të OBT-së nga të gjitha kontinentet dhe në të gjitha nivelet e zhvillimit lëshuan një Deklaratë të Përbashkët për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim, duke bërë thirrje për "diskutime të strukturuar" që synojnë zhvillimin e një kuadri shumëpalësh për lehtësimin e investimeve për zhvillim.

Në nëntor 2019, 98 anëtarë të OBT-së u angazhuan në një deklaratë të dytë të përbashkët për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim për të intensifikuar punën për zhvillimin e një kuadri (marrëveshjeje) për lehtësimin e investimeve të huaja direkte në lidhje me mallrat dhe shërbimet dhe për të punuar drejt një rezultati konkret.

Që nga fillimi i negociatave, anëtarët pjesëmarrës kanë bërë përparim të rëndësishëm në shtyllat kryesore të një Marrëveshjeje të ardhshme për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim, si për transparencën e masave të investimit. "Teksti i Pashkëve", teksti bazë i negociatave, arriti të konsolidohej me përfundimin e vitit 2022 në atë që do të konsiderohet tanimë "Draft IFD Agreement", i cili do të shërbejë si baza për vazhdimin e negociatave. Ky tekst është një hap i rëndësishëm drejt përmbylljes së një Marrëveshjeje të OBT-së për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim.

2.2.7.8. Website i ri i AIDA

Drejtoria e Investimeve u përfshi gjatë vitit 2022 në procesin e ridizenjimit të website-it të AIDA-s. Ndërfaqja e re u dizajnuar duke patur në vëmendje praktikën e faqeve më të mira të agjencive të investimit në botë. Në funksion të ndryshimit vizual, por dhe të përpunimit të informacionit për t'iu përshtatur formës së re, nga Drejtoria e Investimeve u ideuan dhe u realizuan materiale të reja për sa i përket përshkrimit të shërbimeve që AIDA ofron, iniciativave kryesore në të cilat marrim pjesë, informacione sektoriale të natyrës informuese dhe promociionale, etj. Gjithashtu informacioni i publikuar përditësohet vazhdimisht, në varësi të zhvillimeve të reja në secilin prej sektorëve që AIDA promovon, por dhe në materialet promovuese si "Bring your Business to Albania" apo "Albania Calls".


2.3. INVESTIMET STRATEGJIKE

2.3.1. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të paktës së re ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet e vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përsheptuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik;
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS);
- Agjent asistues i investitorit strategjik;



Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe më pas të koordinojë vendimmarrjen.

Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjik (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucioneve njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet e KIS për një projekt janë reduktuar. (Ligji 55/2015 parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga grupi operacional). Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Për këtë arsye, Grupet Operacionale japin kontributin e tyre, njëkohësisht, edhe për vlerësimin teknik të projektit, edhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen se duhet t'i jepen projektit. Mbi këtë bazë, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: (i) raport të vlerësimit teknik dhe (ii) plan veprimi. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS.

2.3.2. Projektet të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2020 dhe 2021

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2020-2021

VITI	2021	2022	TOTALI
Projekte totale	22	12	34
Projekte të miratuara	17	4	21
Projekte të refuzuara	1	2	3
Shqyrtime të tjera të miratuara*	4	6	10

Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2022 AIDA ka asistuar në fazë paraprake edhe 21 projekte, të cilat, për arsye të ndryshme nuk janë pranuar si aplikime ose subjektet aplikues nuk kanë vijuar me aplikimin përfundimtar, duke e çmuar atë për një moment të dytë.

* Shqyrtimet e tjera që ka bërë KIS përgjatë vitit 2022 kanë të bëjnë me:

- ndryshimin e vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike për 4 projekte;
- mospranimin e ndryshimit të 1 projekti;
- transferimin e parcelave të lira, pronë shtetërore, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.

2.3.3. Projektet sipas sektorëve strategjikë


Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2022 i përkasin sektorit të turizmit, i cili ka numrin më të madh të projekteve të investimit (3), duke u ndjekur më pas nga sektori i agroturizmit (1).

Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2022 janë trajtuar:


- 4 projekte në sektorin e turizmit, prej të cilëve janë miratuar 3 dhe është refuzuar 1;
- 2 projekte në sektorin e agroturizmit, prej të cilëve është miratuar 1 dhe është refuzuar 1;

Të shprehura në formë grafike:

Në vitin 2021, projektet në sektorin e turizmit zënë 85% të projekteve të miratuara në total., ndërkohë që sektorët e bujqësisë, energjisë dhe të zhvillimit ekonomik zënë respektivisht 5 %.



Më poshtë, në formë grafike projektet e miratuara në total, sipas sektorëve, për vitet 2021 - 2022.



2.3.4. Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, si dhe shtimin e numrit të investorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitivisht mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se, në fillimet e zbatimit të tij, investorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të tij. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investorët, qofshin këta vendas apo të huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përsheptuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitucional shumë funksional. Së fundmi, përfshirja në ligj e zonave me prioritet zhvillimi, si një sektor strategjik, përbën një mekanizëm akoma dhe më efikas për të akomoduar investime strategjike me impakt të theksuar social dhe ekonomik për zona të veçanta.

3 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

3.1.HYRJE

Drejtoria NVM dhe Projekte pranë AIDA-s ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.1.1.Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 2022

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin e vendit, shprehur kjo nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat, si dhe në kontributin e të ardhurave kombëtare.

Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet me aktivitet tregtar numërojnë 26,5% ndaj totalit të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2022. Aktiviteti tregtar realizon edhe xhiron vjetore më të madhe në ekonomi, me 35,8%.

Rreth 85,6% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar dhe kontributi i tyre llogaritet në 22,0% në punësim dhe 25,2% në realizimin e xhiros vjetore.

Realizojnë 46,5% të totalit vjetor të xhiros. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,6% të totalit të ndërmarrjeve, punësojnë 50,6% të të punësuarve gjithsej, dhe realizojnë 41,3% të totalit vjetor të xhiros.

Në qarqet Tiranë, Durrës e Vlorë janë përqendruar rreth 64,8% e ndërmarrjeve. Numri më i madh i ndërmarrjeve shënohet në qarkun e Tiranës me 58.828 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit me 1.342 ndërmarrje.

Mbizotërimi i grupit të prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha qarqet. Në qarqet Tiranë dhe Durrës janë përqendruar 57,8% e grupit të prodhuesve të shërbimeve.

Gratë menaxhojnë/zotërojnë 31,2% të ndërmarrjeve gjithsej. Aktivitetet “Tregti” dhe “Shërbime të tjera” shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, respektivisht me 34,2% dhe 40,2%. Ndërmarrjet e drejtura nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1- 4 të punësuar. Gratë zënë 47,0% të të punësuarve gjithsej dhe sektori me përfaqësimin më të ulët të tyre është sektori i ndërtimit me 17,0%.

3.1.2. Ndërmarrje aktive (përfshirë fermerët), në 2022

- 125.222 është numri i ndërmarrjeve në fund të vitit 2022 duke shënuar një rritje prej 5,6% krahasuar me vitin 2021;
- 15.700 ndërmarrje janë regjistruar gjatë vitit 2022, nga 14.946 të regjistruar gjatë vitit 2021;
- 86,5% e ndërmarrjeve janë prodhues të shërbimeve, nga 86,6% që ishin respektivisht në vitin 2021;
- Në bashkinë Tiranë, Durrës dhe Vlorë, janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, ndërsa në bashkinë Pustec shënohet numri më i ulët;
- Ndërmarrjet e mëdha me 50 e më shumë të punësuar zënë vetëm 1,6% ndaj totalit të ndërmarrjeve. Kontributi i tyre në punësim llogaritet në 50.6% në vitin 2022, nga 51,1% në vitin 2021;
- 5,3% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të huaja e të përbashkëta, nga ku 43,6% e tyre janë me origjinë nga Italia dhe 5,2% nga Greqia;
- Numri i të punësuarve gjithsej nga ndërmarrjet aktive në fund të vitit 2022 është 730.450, nga të cilët 343.233 janë të punësuar gra;

3.1.3. Ndërmarrjet aktive grupuar sipas numrit të të punësuarve

Tab.1



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik

Tab.2

Aktiviteti Ekonomik	Gjithsej	Regjistruar gjatë vitit 2022
Gjithsej	125,222	15,700
Bujqësia, pyjet, peshkimi	1385	189
Industria	9.322	938
Ndërtimi	6.235	1.099
Tregëtia	43.885	4.161
Transporti dhe makazimi	6.046	658
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.452	1.960
Informacioni dhe komunikacioni	4.872	1.429
Shërbime të tjera	36.025	5.266

3.1.4. Tregtia e jashtme e mallrave në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM):

Eksport/Importet në NVM


Në vitin 2022 eksportet e mallrave janë 487 miliard lekë, duke u rritur 32,0 % krahasuar me vitin 2021. Ndërsa importet e mallrave arrijnë vlerën 950 miliard lekë, duke u rritur 18,7 % krahasuar me vitin 2021.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2022 është 3.604, duke u rritur me 13,2 % krahasuar me vitin 2021. Ndërsa numri i ndërmarrjeve importuese është 13.137 ndërmarrje, duke u rritur me 8,5 % krahasuar me vitin 2021. Në vitin 2022 pesha e eksporteve është 33,9 %, duke u rritur 32 % krahasuar me vitin 2021. Ndërsa pesha e importeve në vitin 2022 është 66,1 %, duke u rritur 18,7 % krahasuar me vitin 2021.

Në vitin 2022, numri i ndërmarrjeve importuese është 13.137 ndërmarrje, duke u rritur me 8,5 % krahasuar me një vit më parë. Pesha e ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme është 99 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) është 68 %, ndërmarrjet e vogla është 23 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 7 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 1% .

Ndërmarrjet, sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2022

Tab.3



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

3.2. Fondet dhe Aksesit në Financa

3.2.1. Fondet

Në datë 21 Prill të vitit 2022 hyri në fuqi Ligji Nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Ky ligj u hartua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me AIDA-n dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të ekosistemit, me qëllim përcaktimin e përkufizimit dhe formave të mbështetjes shtetërore për sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Gjithashtu, AIDA dhe një grup pune i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të TAIEK, punuan së bashku për hartimin e skemës së re në mbështetje të NMVM-ve shqiptare dhe miratuan ndryshimet që erdhën nga reagimet e komunitetit të biznesit, direktivat e BE-së dhe rekomandimet e ekspertëve.

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2022 “Për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, Të Vogla Dhe Të Mesme” është hartuar dhe miratuar VKM nr. 540, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushtet e veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2022”, sipas të cilit AIDA menaxhon fondin për zhvillimin e NMVM-ve.

Në zbatim të VKM Nr.540, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushtet e veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2022”, AIDA shpalli në datë 31 Gusht 2022 hapjen e “Fondit të AIDA-s për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Fokusi kryesor i thirrjes ishte mbështetja me grant në masën 80% të kostove të miratuara për NMVM-të të cilat dëshironin të digjitalizonin biznesin e tyre. Çdo subjekt përfitues nuk mund të mbështetej në vlerë më të lartë se ALL 2,500,000 dhe fondi total për digjitalizimin e NMVM-ve ishte në vlerën ALL 105,000,000.

Në kuadër të promovimit të grantit u zhvillua një fushatë gjithëpërfshirëse informuese, gjatë së cilës u ndoqën hapat si më poshtë:

- Krijimi i një leaflet prezantues me informacione për grantin;
- Zhvillimi i katër sesioneve informuese me përfaqësues të bizneseve nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë. (Dibër, Vlorë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Kukës, Gjirokastrë, Korçë). Në këto sesione morën pjesë në total 125 subjekte;
- Zhvillimi i një aktiviteti open day (ditë e hapur);
- Zhvillimi i 180 takimeve individuale me subjekte të interesuara për të aplikuar;
- Promovim i vazhdueshëm në rrjetet sociale të AIDA-s (përgatitja e 46 postimeve të dedikuara për informim);
- Promovim në median e shkruar (Revista Monitor dhe Revista Business Mag).

Thirrja qëndroi e hapur deri në 21 Tetor 2022, dhe në total aplikuan 480 subjekte për financim me grant. Aplikimet janë marrë në dorëzim dhe shqyrtuar nga njësia menaxhuese e grantit pranë AIDA-s në lidhje me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në rregulloren e grantit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve të përgjithshme nga njësia menaxhuese, të gjitha materialet i kaluan për shqyrtim Bordit të Vlerësimit.

3.2.2. Platforma “AKSES NË FINANCË”

AIDA menaxhon platformën “Akses në Financë” për t'i shërbyer NMVM-ve, të cilat duan të zgjerohen dhe investojnë në aktivitetin e tyre, duke përfutur nga mundësitë financiare që ofron tregu nderkombetar, me grante, kredi apo iniciativa të tjera financimi.

Ndërtimi i platformës “Akses në Financë” është bërë i mundur me rekomandimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si edhe me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Platforma “Akses në Financë” (<https://aida-smefinance.gov.al/>), është një portë unike për biznesin vendas, duke ofruar informacion të përditësuar mbi mundësi e burime financiare, grante, kredi apo nisma të tjera financuese. Kjo platformë online ofron shërbimin “one-stop-shop” me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë për NMVM, i cili ofrohet nga institucione, organizata apo kompani të ndryshme private dhe publike, kombëtare e ndërkombëtare.

AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka ndjekur, asistuar dhe dhënë kontribut të vazhdueshëm gjatë krijimit të platformës, në bashkëpunim me kompaninë zhvilluese të saj. Platforma u lançua gjatë muajit maj 2021 dhe aktualisht përditësohet periodikisht nga AIDA me thirrje të reja dhe mundësi financimi për NMVM-të, njëkohësisht duke asistuar dhe dhënë përgjigje rast pas rasti dhe sipas nevojës së kompanive të interesuara për të aplikuar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 platforma u pasurua me disa funksionalitete të reja të cilat lehtësojnë qasjen në informacionin e nevojshëm për të aplikuar për grante apo skema të ndryshme financiare, si dhe ndihmojnë ndërlidhjen biznes- konsulent duke lehtësuar jo vetëm aksesin në financë, por edhe rrjetëzimin e komunitetit të biznesit.

Një ndër risitë e prezantuara në platformë është edhe mundësia për regjistrimin e konsulentëve, të cilët mund t'i ofrojnë bizneseve të regjistruara në platformë ndihmë dhe këshillim gjatë procesit të aplikimit për grante apo skema të ndryshme financiare. Në këtë mënyrë, AIDA synon të krijojë rrjetin më të madh virtual të konsulentëve në vend.

3.2.2.1. Statistika mbi platformën

Për periudhën janar – dhjetor 2022, në platformë janë publikuar gjithsej 36 thirrje për aplikim për grante ose skema të tjera financiare. Gjithashtu, platforma është vizituar 24,021 herë në total.

Prej muajit janar – dhjetor 2022, platforma ka patur 4111 përdorues, nga të cilët 3258 kanë qenë përdorues të rinj.

Mesatarisht në platformë publikohen 4 thirrje të reja në muaj. Nga shkalla e frekuentimit, vihet re se thirrjet e vizituara më shpesh janë ato që kanë në fokus inovacionin, teknologjinë dhe edukimin.

Mosha mesatare e vizitorëve është 25-34 vjeç, me një përqindje prej 33.5% dhe më pas vijnë vizitorët e moshës 18-24 vjeç me një përqindje prej 27.5%. Vizitorët e platformës janë më së shumti nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia, Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar.

Për të marrë buletin elektronik të thirrjeve deri tani janë regjistruar gjithsej 229 subjekte, ku prej tyre 123 janë NVM dhe 106 persona fizik.

3.3. Nisma të tjera në kuadër të zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme

- Grupi i punës për zhvillimin e nismës “Zhvillimi i Tregtisë Elektronike”, i përbërë nga AIDA në bashkëpunim me Bankën Botërore, hartuan, publikuan dhe prezantuan Guidën “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pyetësin “Self-Assessment Tool”, si dhe një seri trajnimesh të dedikuara specifikisht kësaj nisme;
- AIDA ka qenë partnere në projektin Beyond IDEA duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që prej promovimit, vlerësimit të planeve të biznesit dhe shpallja e finalistëve. Gjatë vitit 2022, 15 start-upe inovative u kualifikuan si finalistë për iniciativat e tyre për të forcuar kompetencat sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit;

- AIDA ka zhvilluar një sërë takimesh me institucione publike dhe private në kuadër të zhvillimit të NMVM-ve, si SWISS, AECA, USAID, Dhoma Ekonomike e Gruas në Shqipëri, Departamenti i Ndërmarrësisë-Ministria e Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë, Kosovë, Banka Botërore, Forum Sa, si dhe ITC “Trade development project in Albania- programming mission”;
- U përditësuan dhe u shtuan informacione për profilet e kompanive në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, sipas formatit të ri. Në këtë platformë janë në total, 1057 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e tyre ndaj partnerëve potencialë për bërjen e biznesit brenda dhe jashtë vendit;
- Vijimi i fushatës për promovimin e produkteve “Made in Albania”. Në bazë të interesit të lartë të shprehur nga vetë kompanitë, por edhe bizneseve të kontaktuar nga stafi i AIDA-s, është bërë identifikimi i produkteve vendase për fushatën “Zgjidh të Vendit” dhe përshkrimi i tyre. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 është realizuar promovimi në rrjetet sociale të institucionit i 90 produkteve lokale;
- Publikimi i katalogut të tretë të produkteve “Made in Albania”. Katalogu prezanton në përmbajtjen e tij 86 produkte për periudhën 2021-korrik 2022;
- Zhvillimi i katër sesioneve informuese mbi Fondin për Zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me përfaqësues të bizneseve nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë. (Dibër, Vlorë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Kukës, Gjirokastrë, Korçë). Në këto sesione morën pjesë 125 subjekte në total;
- Zhvillimi i takimeve informuese individuale mbi Fondin për Zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme me 35 subjekte të interesuara pranë zyrave të AIDAs;
- Pjesëmarrje dhe kontribute në grupe pune ndërinstitucionale dhe aktorë në ekosistemin e NMVM-ve;
- Pjesëmarrje në Takimin "Mock Excercise" për Kriterin Ekonomik, për përgatitjet për Takimin Bilateral me shërbimet e BE-së;
- Pjesëmarrje në takimin për misionin mbështetës nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2023-2025;
- Pjesëmarrje në trajnimin online mbi Standardet e BIO Suisse, i cili mbështetet nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian (SECO) dhe implementohet nga FiBL, IFOAM, Helvetas dhe partner lokal AAM;
- Takim me ekspert të USAID në kuadër të një vlerësimi strategjik mbi zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri;
- Takim me ekspert të GIZ dhe shoqatës Federale Gjermane të sektorit organik lidhur me mundësitë e bashkëpunimit mes kompanive shqiptare dhe gjermane të sektorit organik;
- Pjesëmarrje në takim me përfaqësues të GIZ në Shqipëri në lidhje me temën "Green Economy Scoping Study – Albania”;
- Pjesëmarrje në dy takime të realizuara nga ekspertët e instrumentit TAIEK të Komisionit Evropian, në kuadër të procesit të ERP;
- Takim me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, GIZ Albania, SIPPO Albania, Albanian Association of Marketing, në kuadër të rezultateve të pjesëmarrjes në panairin Biofach 2022, organizimit të ardhshëm, aktiviteteve të tjera me fokus sektorin organik, si edhe politikave dhe rregulloreve për zhvillimin e sektorit organik.

3.4. Pjesëmarrja në Konferenca dhe Forume

- Pjesëmarrje në takimin e 13-të të Nënkomitetit për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit, Politikën Sociale / Bashkimi Evropian – Shqipëri;
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga UCCIAL për tregtinë elektronike;
- Pjesëmarrje në aktivitetin Online Meeting World Bank Digital Trade Project – SME digitalization/e-commerce trainings;
- Takim online me SIPPO Albania dhe shoqatën PRO Eksport Albania, për kalendarin e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta “Apparel Manufacturing Made-in-Albania export promotion 2022-2023 SIPPO”;
- Takim online në kuadër të projektit “CEI Know How Program” organizuar nga Agjencia Bullgare e promovimit të bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Pjesëmarrje në webinarin: “Rast studimor për zbatimin e masave të efikasitetit në energji, energjisë së rinovueshme dhe sistemeve të menaxhimit të mbetjeve”;

- Ndjekje e takimit me përfaqësues të Bankës Botërore në Shqipëri për mbështetjen e SME-ve për akses në financë, mbështetjen financiare të sektorit agrar dhe platformat A2F;
- Pjesëmarrje në ciklin e seminarave të organizuara nga EBRD “Mbi eficientësinë në energji dhe menaxhimin e mbetjeve” në Hotele dhe Struktura Akomoduese;
- Pjesëmarrje në sesionin e trajnimeve për gratë sipërmarrëse në bizneset e vogla dhe të mesme, që operojnë në sektorët e turizmit dhe agropërpunimit, organizuar nga EBRD, në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Gruas dhe AIDA.
- Pjesëmarrje në ciklin e seminareve të organizuara nga UNECE, me tematikë: “1. Roli i MSME-ve dhe sipërmarrja në post Covid -19, ringritja e tregtisë së qëndrueshme, ekonomisë së gjelbër dhe rrethore” dhe “2. Rritja e kontributit të MSME-ve në lehtësimin e tranzicionit të ekonomisë rrethore dhe të gjelbër post Covid -19”.
- Pjesëmarrje në forumin e biznesit me tematikë “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi”, i cili u zhvillua nga KASH, si edhe në workshopin me tematikë “Ruga e eksporteve shqiptare të frutave dhe perimeve drejt tregjeve evropiane me standart të lartë, i prezantuar nga eksperti britanik, Richard Arnold – RGA Consulting, zhvilluar në kuadër të panairit Ditët e Bujqësisë;
- Takim online për negociatat për hyrjen në programin Single Market: First formal negotiations round on the association of Albania to the Single Market Programme;
- Pjesëmarrje në Workshopin hibrid mbi lançimin e versionit të përshtatur në shqip të botimit – “Idetë sipërmarrëse: Një udhëzues për pronësinë intelektuale për startup-et” organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale;
- Pjesëmarrje në “Takimin e 13-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”, datë 29 qershor 2022;
- Zhvillimi i takimit online mbi prezantimin/lançimin e guidës “Si të nisësh një biznes e-commerce”. Gjatë takimit online u prezantua udhëzuesi “Si të nisësh një biznes e-commerce”, në ndihmë të sipërmarrjeve dhe palëve të interesuara në zhvillimin e tregtisë elektronike;
- Pjesëmarrje në 7 ciklet e trajnimeve të organizuar nga AIDA – AITA –BERZH në lidhje me tregtinë elektronike. AIDA mori pjesë në cilësinë e bashkëorganizatorëve dhe trajnuesve për disa nga temat e trajtuara në ciklin e trajnimeve;
- Pjesëmarrje në webinarin “ETF meeting Skills for Enterprise Development (S4E) Launch Event – Skilling up the Western Balkans agri-food sector: digitalizing, greening is about to start”;
- Pjesëmarrje në konferencën “Western Balkans Conference: Smart, Secure, Green City Solutions”;
- Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga RISI Albania në Panairin e Bujqësisë, me temë “Rrugëtimi i eksporteve shqiptare të fruta perimeve drejt tregjeve ndërkombëtare”;
- Pjesëmarrje në aktivitetin: Ditët e Eksportit Organik 2022 (Online) – Shqipëri, Serbi, Ukrainë;
- Pjesëmarrje në Takimin "Mock Excercise" për Kriterin Ekonomik, për përgatitjet për Takimin Bilateral që do të zhvillohet me shërbimet e BE-së;
- Pjesëmarrja në Export Promotion Conference, pranë ExpoCity, për panairin Conference Leather;

3.5.PANAIRE DHE AKTIVITETE TË REALIZUARA NË MBËSHTETJE TË NVM-ve.

Një nga funksionet e Drejtorisë është mbështetja dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për NVM-të shqiptare. Në kuadër të këtij funksioni, gjatë vitit 2022 AIDA ka organizuar aktivitete, seminare informuese dhe takime “Door to Door” me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron, si dhe mundësitë e përfitimit nga aksesit në financë.

- AIDA vazhdoi menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Pavionit të Shqipërisë në EXPO DUBAI 2020, si dhe ndoqi eventet ku Shqipëria ishte e pranishme, të organizuara nga pavionet e tjera pjesëmarrëse;
- AIDA në bashkëpunim me SIPPO Albania dhe shoqatën Pro Export Albania, organizuan një Study Tour në panairin “SICUR Madrid” në datat 22-24 Shkurt 2022;
- AIDA zhvilloi një takim online me SIPPO Albania dhe shoqatën PRO Eksport Albania, për kalendarin e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta “Apparel Manufacturing Made-in-Albania export promotion 2022-2023 SIPPO”;

- AIDA zhvilloi takim me përfaqësues të EXPO CITY, në kuadër të zhvillimit të panairit të Turizmit “ITE days”, Ditët Ndërkombëtare të Turizmit & Mjedisit, 02-04 Qershor 2022;
- AIDA zhvilloi takim me Menaxherin e Projektit të International Agrotech Expo 2022, në kuadër të përgatitjes së Panairit Edicioni i 3të i Agrotech Expo, 24-26 Nëntor 2022.
- AIDA u përfaqësua me stendë në panairin ‘Ditët e Bujqësisë’, 19-21 Maj 2022, Lushnjë;
- AIDA zhvilloi takim me kompanitë e sektorit të bujqësisë, ku bëri një prezantim të sektorit të Bujqësisë dhe shërbimeve që ofron AIDA në ndihmë të biznesit, i organizuar në kuadër të panairit “Agriculture Days” 19-21 Maj 2022 Lushnjë;
- AIDA mori pjesë në workshopin online të organizuar nga SIPPO Albania me kompanitë e sektorit të bimëve medicinale në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrje në panairin “Biofach 2022”;
- AIDA organizoi takim me kompanitë pjesëmarrëse në Panairin “Biofach Albania” 26-29 Korrik 2022, së bashku me SIPPO Albania në kuadër të fillimit të përgatitjeve për panairin e bimëve medicinale;
- Stafi i AIDA-s dhe SIPPO-s vizitoi kompaninë BIDA sh.p.k në qytetin e Kavajës, në kuadër të këshillimit dhe mbështetjes për një pjesëmarrje sa më të suksesshme të kompanisë në BIOFACH 2022;
- AIDA dhe SIPPO vizituan fabrikën e kompanisë BIOBES në qytetin e Divjakës duke vazhduar misionin për zgjerimin në tregje të huaja të kompanive shqiptare në Sektorin e Bimëve Medicinale & Aromatike, në kuadër të këshillimit dhe mbështetjes për një pjesëmarrje sa më të suksesshme të kompanisë në BIOFACH 2022;
- Stafi i AIDA-s dhe SIPPO-s vizitoi kompaninë “Vasil Mama & Co” në qytetin e Gramshit, duke vazhduar misionin për zgjerimin në tregje të huaja të kompanive shqiptare në Sektorin e Bimëve Medicinale & Aromatike, në kuadër të këshillimit dhe mbështetjes për një pjesëmarrje sa më të suksesshme të kompanisë në BIOFACH 2022;
- Stafi i AIDA-s dhe SIPPO-s vizitoi kompaninë “Çibuku sh.p.k” në qytetin e Korçës, duke vazhduar misionin për zgjerimin në tregje të huaja të kompanive shqiptare në Sektorin e Bimëve Medicinale & Aromatike, në kuadër të këshillimit dhe mbështetjes për një pjesëmarrje sa më të suksesshme të kompanisë në BIOFACH 2022;
- Takim/ sesion përgatitor mbi përdorimin e platformës e-talque me kompanitë pjesëmarrëse në panairin “Biofach Albania” 26-29 Korrik 2022, organizuar nga AIDA së bashku me SIPPO Albania;
- Pjesëmarrje në panairin e bimëve medicinale dhe aromatike Biofach 2022, 26-29 Korrik, Nuremberg, Gjermani;
- Pjesëmarrje me stendë në “Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së gjelbër 2022” në Tiranë, Shqipëri;
- Pjesëmarrje me stendë në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës, në datat 1 – 4 dhjetor, organizuar nga Klik Expo Group;
- Pjesëmarrje në aktivitetin: Ditët e Eksportit Organik 2022 (Online) – Shqipëri, Serbi, Ukrainë.

3.6.BASHKËPUNIME DHE PARTNERITETE TË REALIZUARA NË KUADËR TË të NMVM-ve DHE PROJEKTEVE

Pjesëmarrje në trajnimin online mbi Standardet e BIO Suisse i cili mbështetet nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian (SECO) dhe implementohet nga FiBL, IFOAM, Helvetas dhe partner lokal AAM.

3.7 ROLI I AIDA-s NË MBËSHTETJEN NDAJ KËTYRE SUBJEKTEVE

Drejtoria NVM dhe Projekte pranë AIDA-s ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

• Promovim i Produkteve “Made in Albania”

‘Zgjidh të vendit’ është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 është realizuar promovimi në rrjetet sociale të institucionit i 90 produkteve lokale.

Në kuadër të nismës për promovimin e produkteve “Made in Albania”, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve publikoi “Zgjidh të Vendit”, katalogun e tretë të produkteve “Made in Albania”. Katalogu prezanton në përmbajtjen e tij 86 produkte për periudhën gusht 2021-korrik 2022.

• Platforma “BUSINESS TO BUSINESS

Platforma “Business to Business”, (B2B) është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime të suksesshme midis bizneseve. Kjo platformë është një “mekanizëm” lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit. Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, deri në fund të vitit 2022 janë publikuar në total 1057 profile të kompanive shqiptare, me qëllim rritjen e vizibilitetit të kompanive ndaj partnerëve potencialë.

Për t’u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

3.8.STRATEGJIA E EKSPORTEVE

Është krijuar Grupi i Punës për hartimin e Programit të Eksporteve. Në zbatim të Urdhrit nr. 19 prot., datë. 21.01.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit “Për nxitjen e Eksporteve dhe Ndërkombëtarizimin 2022-2027”, i përbërë nga 21 anëtarë nga institucione të ndryshme të qeverisë, AIDA, si pjesë e grupit të punës, ka përgatitur pyetësorin e eksporteve dhe me miratimin e grupit të punës, ka anketuar 325 kompani për të vlerësuar situatën aktuale mbi eksportet e tyre dhe për të marrë parasysh nevojat e tyre në strategjinë e eksportit.

Të dhënat janë mbledhur në mënyrë konfidenciale dhe mbulojnë periudhën nga 23 mars deri më 31 maj 2022. Pyetësorit iu përgjigjën 130 kompani. Pas analizimit të rezultateve të pyetësorit, u identifikuan masat dhe shërbimet në dispozicion të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në mbështetje të aktiviteteve të tyre eksportuese, qasjet/propozimet më të mira dhe të suksesshme dhe masat proaktive për të stimuluar eksportet dhe për të ofruar mbështetje (financiare dhe jofinanciare) për bizneset.

Analiza e rezultateve të pyetësorit të eksporteve, e kryer nga AIDA, i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të vijuar me hartimin e Programit “Për nxitjen e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin 2022-2027.

3.9.PROJEKTE TË MENAXHUARA NGA AIDA

Gjatë vitit 2022 AIDA dakordësoi pjesëmarrjen e Shqipërisë nëpërmjet aplikimit të AIDA-s në projektin CEI Know-How Program me fokus “Inovacioni në FinTech” si pjesë e një konsorciumi me Bullgarinë, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainën;

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 AIDA aplikoi dhe u shpall fituese nën thirrjen “Skills for Sustainable Employment and Inclusive Economic Growth of Cross-Border Region of Albania and Montenegro - Skills for Jobs Albania – Montenegro Cross-Border Cooperation Programme Montenegro - Albania 2014-2020 under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II)”. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve së bashku me organizatën Foundation Business Start-Up Centre dhe Dhomën Ekonomike të Malit të Zi janë partnerë në këtë program. Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxitja e punësimit dhe përfshirja sociale duke lehtësuar hyrjen në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Target-grupi i synuar përfshin punëkërkesit me nivel të ulët dhe të mesëm arsimimi, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk përputhen me kërkesën e tregut të punës, të rinjtë (mosha 15 deri në 29 vjeç) dhe gratë që kërkojnë punësim.

3.9.PROJEKTE TË MENAXHUARA NGA AIDA

- Përditësim për Kontributin e I-re të Qeverisë shqiptare për Raportin e KE 2022 për kap.20 “Kriterin Ekonomik” dhe “Ndërmarrjet dhe Politikat industriale”.
- Përditësim informacioni mbi Dimensionet e SBA policy index 2022.
- Përditësim për Monitorimin e rekomandimeve të KE 2021 për “Kriterin Ekonomik” dhe për kap.20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”;

- Përditësimi i materialit për “MAP REA”;
- Përditësim dhe kontribut për Kapitullin 25 ‘Shkenca dhe Kërkimi Shkencor’;
- Përgatitje e kontributit për progres Raportin e kap.20;
- Kontribut për raportimin në kuadër të Takimit të Nënkomitetit Shqiperi-BE “Për Çështjet Ekonomike e Financiare dhe Statistikat ECOFIN 2022”;
- Pjesëmarrje në takimet me anëtarët e GNPIEs për Kapitullin 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”.
- Pjesëmarrje në takimin përgatitor, në kuadër të raportimit të Shqipëri – BE, për Nënkomitetin e Çështjeve Ekonomike dhe Financiare dhe Statistikat
- Përgatitje informacioni në kuadër të përgatitjes së raportit “Trade Review”, nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)
- Pjesëmarrje online në takimin shpjegues “screening” që u mbajt në Bruksel për kapitullin 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”.
- Përgatitje informacioni dhe dhënie kontributi për hartimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) për periudhën 2023-2025.
- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2023-2030.

4 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË

4.1.Hyrje

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka për funksion sigurimin e Komunikimit dhe Marketingut të institucionit për politikat, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj. Po ashtu, kjo drejtori ka për funksion kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t’i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Misioni i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është arritja e objektivit mbi informacionet mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri. Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja, kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

Drejtorja e Marketing dhe Kërkim Analizë në mbështetje të drejtorive të tjera të Agjencisë, përgjatë vitit 2022, krahas rritjes së kanaleve të komunikimit, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e komunikimit.

4.2.Publikime në media sociale

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka mundësuar në vazhdimësi përditësimin me informacion, si edhe pasqyrimin në kohë, në të gjitha kanalet e komunikimit (Website, Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter). Të gjitha aktivitetet, takimet zyrtare, konferencat, trajnimet, seminare dhe panairët, janë pasqyruar në faqen Web dhe në Rrjetet Sociale

publikimeve në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe shoqërimit me foto, video dhe infografe ilustruese. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me link nga faqja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faqja zyrtare e institucionit, si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investitorëve, partnerëve dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare www.aida.gov.al në kohë reale. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

4.2.1. AIDA Website

Faqja web e AIDA-s, përmban informacione të rëndësishme në ndihmë të investitorëve, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të web-it të Agjencisë, www.aida.gov.al, kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketing miks synon tërheqjen e një numri në rritje të investitorëve potencialë për të vizituar faqen.

4.2.2. Rrjete sociale

AIDA mbulon me informacione edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, për t'ju ardhur në ndihmë të palëve të interesuara, si dhe për ta bërë më të lehtë marrjen e informacionit. Aktualisht AIDA ka në përdorim faqet: **Facebook** - AIDA - Albanian Investment Development Agency, **Instagram** - @aida__albania, **LinkedIn** - AIDA - Albanian Investment Development Agency, **Twitter** - @investinalbania.

AIDA Facebook

Faqja e facebook ka një audiencë të lartë, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht që prej krijimit të faqes në vitin 2016.

Faqja facebook përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike etj. Për vitin 2022 janë bërë 335 postime.

AIDA Twitter

AIDA është aktive edhe në rrjetin social twitter duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme. Për vitin 2022, janë bërë 180 postime gjithsej.

AIDA Instagram

Profil i ri i AIDA-s në instagram u krijua përgjatë vitit 2019, duke krijuar një rritje dhe njohje nga një masë me e gjerë e shërbimeve dhe rolit të institucionit. Për vitin 2022, janë bërë gjithsej 318 publikime.

AIDA LinkedIn

AIDA ka aktualisht dhe një faqe në rrjetin social LinkedIn për të qënë më afër ndjekësve të saj. Për vitin 2022, në rrjetin social LinkedIn janë bërë 208 postime.

Faqja zyrtare AIDA-s, së bashku me rrjetet sociale (Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn), kanë qënë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s, për t'u njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara. Në total, në të gjitha adresat e AIDA-s janë bërë 1041 postime.

4.2.3. Prezantimet video

Përgjatë vitit 2022, AIDA ka publikuar 7 video. Përgatitja e formateve video ka si qëllim të japë një mesazh dhe njohë kompanitë NMVM, në mënyrë konkrete dhe për ta bërë sa më të prekshme, ndihmën që AIDA ofron nëpërmjet mbështetjes së kompanive për pjesëmarrjen në panairë, gjetjen e klientëve potencialë dhe nënshkrimin e kontratave. Videot gjithashtu trajtojnë çështje dhe ndajnë eksperiencat mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij, video të aktiviteteve të veprimtarisë së AIDA-s, si edhe video mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai

1. Intervista e Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s, Z. Sokol Nano, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Expo 2020 Dubai dhe rastin e Ditës Kombëtare të Shqipërisë

- <https://www.facebook.com/watch/?v=1569160166816621>

2. Video të pesë kompanive pjesëmarrëse në BIOFACH 2022

- <https://www.facebook.com/watch/?v=378492697723875>
- <https://www.facebook.com/watch/?v=781692903185784>
- <https://www.facebook.com/watch/?v=559880122533262>
- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/58402139348324>
- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/1288656035208168>

3. Video informuese mbi mënyrën e aplikimit për fondin e AIDA-s

- <https://www.facebook.com/watch/?v=793518025099307>

4.2.4. Botimet e AIDA-s

Përgjatë vitit 2022, në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit, AIDA ka hartuar dhe dizenuar materiale promovuese (digjitale dhe fizike), për të gjithë sektorët kyç të vendit me fokus investitorët potencialë dhe kompanitë NMVM, të cilat ju vijnë në ndihmë me informacione, si edhe promovimit të veprimtarisë së AIDA-s në aktivitetet pjesëmarrëse.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve dhe u kujdes për përshtatjen, dizenjimin, botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, për t'i bërë sa më të aksesueshme.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë gjatë vitit 2022 pati në fokus zhvillimin dhe përgatitjen e shërbimeve të marketingut në mbështetje të drejtorive të tjera. Një rëndësi ju kushtua cilësisë së përmbajtjes së informacionit të materialeve promovuese si dhe plotësimi të kërkesave të legjislacionit në fushën e botimit.

Përgjatë vitit 2022, AIDA ka publikuar 7 video. Përgatitja e formateve video ka si qëllim të jape një mesazh dhe njohë kompanitë NMVM, në mënyrë konkrete dhe për ta bërë sa më të prekshme, ndihmën që AIDA ofron nëpërmjet mbështetjes së kompanive për pjesëmarrjen në panaire, gjetjen e klientëve potencialë dhe nënshkrimin e kontratave. Videot gjithashtu trajtojnë çështje dhe ndajnë eksperiencat mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij, video të aktivitetve të veprimtarisë së AIDA-s, si edhe video mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai

4.2.4.1. Botime sektoriale për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

- **Ekonomia e Ushqimit- Bujqësia**

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1124-ekonomia-e-ushqimit-bujqesia>

Broshura bën një përshkrim të mekanizmit, inovacionit dhe digjitalizimit në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, agrobiznesit, agropërpunimit, bimëve mjekësore dhe aromatike, bletarisë, agroturizmit, agropylltarin dhe mjedisin në zonat rurale.

- **Sektori i Pijeve dhe Ushqimit**

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1131-industria-e-pijeve-dhe-ushqimit>

Broshura e përditësuar pasqyron zhvillimin e sektorit të industrisë së pijeve dhe ushqimit në Shqipëri dhe mbështetjen e ofruar nga shteti dhe AIDA.

- **Sektori i Bimeve Mjekësore-Aromatike**

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1075-sektori-i-bimeve-mjekesore-aromatike>

Broshura është e përditësuar për vitin 2022 dhe ofron një përmbledhje të sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri nëpërmjet statistikave të

viteve të fundit, proceseve të punës, produktet dhe shërbimet kryesore, avantazhet e sektorit, historitë e suksesit, etj.

- **Sektori i Tekstileve**

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/944-sektori-i-tekstileve>

Broshura pasqyron zhvillimin e sektorit të tekstilit në Shqipëri nëpërmjet statistikave të viteve të fundit, kontributet e sektorit, si edhe avantazhet e operimit në këtë sektor.

- **Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1003-sektori-i-tik>

Ky botim është një përmbledhje e sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Shqipëri, avantazhet, historitë e suksesit, si dhe mbështetja e sektorit nga shteti dhe AIDA.

- **Broshura – Sektori i Turizmit**

https://aida.gov.al/images/PDF/Sektori_i_Turizmit-broshura_compressed.pdf

Broshura është një botim i ri, e cila pasqyron zhvillimin e sektorit të turizmit në Shqipëri, incentivat dhe ndihmën e AIDA-s në mbështetje të këtij sektori, si dhe histori suksesi.

- **Broshura “Enjoy Bio Albania”**

<https://aida.gov.al/.../publications/1292-biofach-2022>

Broshura informuese “Enjoy Bio Albania”, bën një përshkrim të përgjithshëm të sektorit të bimëve medicinal dhe aromatike në Shqipëri, si edhe përmban 5 profilet e kompanive shqiptare që janë pjesë e pavijonit në panairin BIOFACH 2022, si dhe gamën e gjerë të bimëve medicinale dhe aromatike që ato kanë.

4.2.4.2. Botime për promovimin e Investimeve Strategjike

- **Sektori i Agrikuturës, Agroturizmit dhe Akuakulturës**

https://aida.gov.al/images/PDF/Agriculture_FactSheet-Apr%202022.pdf

Broshura e përditësuar pasqyron Sektorin e Agrikulturës dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe skemat ekzistuese që mbështesin zhvillimin e sektorit.

- **Albania Calls - A country of opportunities 2022**

<https://aida.gov.al/images/PDF/Albania%20Calls%202022.pdf>

Broshura përmban informacione të përditësuara për vitin 2022, mbi arsyet kryesore për të investuar në Shqipëri, klimën e biznesit, marrëveshjet e tregtisë së lirë, baza ligjore për investimet e huaja, indikatorët makroekonomik dhe shërbimet e AIDA-s.

- **Booklet Invest in Albania 2022**

https://aida.gov.al/images/PDF/Booklet_InvestInAlbania_AIDA2022.pdf

Broshura është një përmbledhje e informacioneve të përgjithshme për Shqipërinë dhe ekonominë tonë, investimet e huaja direkte, arsyet kryesore për Shqipëria është vendi i duhur për të investuar dhe roli i AIDA-s.

4.2.4.3. Botime të tjera

- **Leaflet “Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”**

https://aida.gov.al/images/PDF/Fondi_MSME%20updated.pdf

Leafleti “Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” përmban të gjithë informacionin për aplikimin për ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për Fondin e menaxhuar nga AIDA, i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2022.

- Pyetësori “Gjendja e tregtisë elektronike (e-commerce) tek ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”

https://aida.gov.al/images/PDF/Rezultatet%20E-commerce_10.06.2022.pdf

Zhvillimi dhe botimi i pyetësorit “Gjendja e tregtisë elektronike (e-commerce) tek ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, është një material sasior dhe rezultatet e tij shërbyen për të përcaktuar nevojat dhe gjendjen e NMVM-ve, lidhur me zhvillimin e tregtisë elektronike dhe përcaktuar prioritetet e ndëhyrjeve nga ana e Qeverisë dhe aktorëve të tjerë, për përmirësimin ose përforcimin e klimës së tregtisë elektronike në Shqipëri.

- Guida “Si të nisësh një biznes e-commerce”

<https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>

Botimi “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pasqyron të gjitha hapat e zhvillimit të një biznesi online. Nëpërmjet këtij botimi AIDA synon që sipërmarrësit në Shqipëri të njihen me tregtinë elektronike si pjesë e rëndësishme e strategjisë së rritjes së biznesit.

- Katalogu i Expo 2020 Dubai “Albania a timeless trip”

<https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/catalog%20expo%20.pdf>

Në katalog përshkruhet koncepti i Pavijonit të Shqipërisë dhe objekteve të ekspozuara në të.

- Katalogu i tretë vjetor “Zgjidh të Vendit”

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1305-katalogu-made-in-albania-3fbclid=IwAR0mf7LU3P9d9X7U9UvJB26GoofXB0F2qgXVUB07Sc2FLVmQgMlhGigaWlU>

Katalogu është një përmbledhje të produkteve “Made in Albania”, për periudhën Gusht 2021 - Korrik 2022.

- Raporti Vjetor 2021

<https://aida.gov.al/images/PDF/Raporti%20Vjetor%2021.pdf>

Raporti Vjetor 2021, prezanton ecurinë e zhvillimeve përgjatë vitit 2021, të arritjeve dhe punës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe në mënyrë specifike të drejtorive në përbërje të saj.

- Revistë elektronike numër 1, 2, 3 dhe 4 për vitin 2021

1. <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1214-katalog>
2. <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1307-newsletter-prill-qershor-2022>
3. <https://aida.gov.al/images/PDF/broshura%20korrik-shtator.pdf>
4. <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1362-broshura-tetor-dhjetor>

Këto publikime shërbejnë si një kornizë pasqyrimi për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2022. Revista elektronike ka si synim të rrisë ndërveprimin e AIDA-s me partnerët, bashkëpunëtorët dhe aktorët e interesit.

4.3.AIDA NË AKTIVITETE

4.3.1.Aktivitetet lokale me qëllim mbështetjen dhe informimin e biznesit

Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve. Përgjatë vitit 2022, AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete, sesione informuese dhe takime me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron.

4.3.2. Panairët dhe roli i AIDA-s në mbështetjen ndaj bizneseve

Mbështetja e bizneseve shqiptare për të marrë pjesë në panaire jashtë vendit është një ndihmë e veçantë e qeverisë shqiptare, nëpërmjet AIDA-s për të nxitur biznesin vendas dhe veçanërisht atë eksportues. AIDA nëpërmjet mbështetjes apo organizimit të pjesëmarrjes në panaire synon promovimin e biznesit shqiptar në sektorë specifike, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e eksportit në këtë sektor, tërheqjen e investitorëve të huaj për investime në vend dhe promovimin e Shqipërisë. Nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve “Made in Albania”.

Panaire 2022

- **Panairi “Ditët e Bujqësisë 2022”**

Në datat 19-21 maj 2022, Lushnjë, u zhvillua Panairi Ndërkombëtar i Bujqësisë, Teknologjive, Ushqimit dhe Përpunimit “Ditët e Bujqësisë 2022”, ku AIDA u organizua për të marrë pjesë me një stendë, me synim promovimin e sektorit dhe produkteve “Made in Albania”, ofrimin e asistencës dhe informacionit mbi sektorin për bizneset dhe palët të interesuara, si dhe organizimin e takimeve për bashkëpunim dhe partneritet mes bizneseve pjesëmarrëse. Përfaqësues nga AIDA, ditën e hapjes së panairit, datë 19 maj, mbajtën dhe një aktivitet prezantues me temë: “Sektori i bujqësisë, inovacioni dhe investimet në këtë sektor”.

- **Panairi “BIOFACH 2022”**

Në datat 26-29 korrik 2022, në Nuremberg, Gjermani, u zhvillua Panairi “BIOFACH 2022”, ku AIDA ishte organizatorja e Pavijonit Shqiptar me mbështetjen e SIPPO Albania. Në stendën e Pavijonit Shqiptar me numër 238, ishin pjesëmarrëse 5 kompani shqiptare të bimeve medicinale dhe aromatike si: Çibuku sh.p.k, Vasil Mama & Co, BIDA sh.p.k, BIOBES sh.p.k, Bioalba Group.

- **Panairi online China International Import Expo**

Në datat 5-10 Nëntor 2022, Shqipëria ishte pjesë për herë të parë në panairin online CIIE (China International Import Expo), e përfaqësuar nga AIDA, me qëllim promovimin e sektorit të turizmit, kulturës dhe artit. Qëllimi i CIIE 2022 ishte gjithashtu, të nxiste sa më shumë investimet e huaja në sektorin digjital ekonomik dhe të ishte një urë lidhëse për eksportin e produkteve midis Shqipërisë dhe Kinës. Pavijoni i Shqipërisë ishte në modelin 3D, ku u shfaqën disa nga kostumet tradicionale Shqiptare, produktet autentike dhe qytetet e mbrojtura nga UNESCO. Gjithashtu, kishte peisazhe të ndryshme të bregdetit dhe turizmit shqiptar. Panairi ofroi një mundësi të mirë për të eksploruar tregun Kinez dhe për të forcuar marrëdhëniet tregtare midis bizneseve.

- **Panairi i Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër 2022**

Në datat 11-12 nëntor 2022, AIDA mori pjesë në Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër 2022, që u zhvillua në Pallatin e Kongreseve. AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një stendë informuese, duke iu ardhur në ndihmë me informacione mbi investimet strategjike në Shqipëri dhe kryesisht në sektorin e energjisë, të gjithë palëve të interesuar që vizituan stendën tonë.

- **Panairi Ndërkombëtar i Tiranës**

Në datat 1 - 4 dhjetor, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë, u mbajt Panairi Ndërkombëtar i Tiranës dhe AIDA ishte pjesëmarrëse me stendë për të asistuar dhe dhënë informacion çdo kompanie pjesëmarrëse shqiptare dhe të huaj, si edhe palëve të tjera të interesuara që vizitojnë panairin. Gjatë eventit AIDA mbajti dhe një prezantim me temë: “Explore the Investment Opportunities in Albania”, ku u prezantua klima e biznesit në vendin tonë, ligji dhe lehtësirat për investimet e huaja, sektorët potenciale në Shqipëri dhe asistencën që ofron agjencia.

4.4. NISMA TË AIDA-S

4.4.1. Fushata "E Dua Shqip"

"E Dua Shqip" është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve "Made in Albania" e cila vijoi edhe për vitin 2022 dhe do të vazhdojë të mbështesë dhe promovojë produktet vendase dhe forcimin e markës "Made in Albania". Gjatë vitit 2022 janë promovuar në rrjete sociale dhe faqen web AIDA 90 infografe të produkteve "Made in Albania".

Qëllimi i kësaj fushate është që të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare.

4.4.2. Fondi për zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)

Në datën 31 Gusht 2022, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shpalli thirrjen për "Fondin për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme".

Ky fond kishte në fokus digjitalizimin e bizneseve shqiptare, si një nga mënyrat kryesore për të ruajtur konkurrueshmërinë në treg, për të qënë sa më koherent, si dhe për të arritur sa më shumë klientë potencialë nëpërmjet platformave digjitale.

Kjo thirrje qëndroi e hapur për aplikime deri në 21 Tetor 2022, si edhe shpallja e ndërmarrjeve fituese të fondit do të kryhet brenda këtij viti.

4.4.3. Fushata promovuese e fondit për zhvillimin e NMVM-ve

Në mënyrë që sa më shumë biznese të ishin të informuar për shpalljen e kësaj thirrjeje, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka ndërmarrë një fushatë të gjerë promovuese përgjatë kësaj periudhë. AIDA, sapo shpalli Fondin, publikoi njëkohësisht edhe Broshurën Informuese mbi qëllimin dhe mënyren e aplikimit, duke vijuar me: Postimin në faqen web AIDA; Postimin në platformën "Akses në Financë"; Postimet në rrjetet sociale të institucionit (Facebook, Instagram, LinkedIn dhe Twitter), të ideuar kryesisht në formën e infografëve, për ta bërë sa më të kuptueshëm shpalljen e thirrjes për aplikime. AIDA, në kuadër të fushatës promovuese organizoi edhe katër sesione informuese dhe një open day, në ambientet e zyrave të agjencisë, me të gjitha bizneset e interesuara shqiptare të ndarë sipas qarqeve të vendit.

Gjithashtu, stafi i AIDA-s, gjatë periudhës që thirrja ka qënë e hapur, ka mirëpritur në takim biznese të cilat kanë kërkuar informacion.

AIDA u angazhua në përgatitjen dhe publikimin e dy materialeve informuese në Business Magazine "Mbështetje për digjitalizimin e NMVM-ve në Shqipëri – Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve" dhe Revista Monitor "Transformimi digjital i bizneseve – Skema më e re e financimit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve", që trajtojnë informacione mbi thirrjen dhe procesin e digjitalizimit të biznesit. Këto artikuj i vijnë në ndihmë bizneseve për të bërë të mundur krijimin e një aplikimi sa më të plotë referuar qëllimit të fondit, si edhe për të informuar bizneset mbi qasjen digjitale të orientuar drejt konsumatorëve, që sa vjen dhe rritet në ditët e sotme.

Artikujt e publikuar mund t'i shfletoni në linqet:

<https://businessmag.al/mbeshtetje-per-digjitalizimin-e-nmvm-ve-ne-shqiperi-agjencia-shqiptare-e-zhvillimit-te-investimeve/>

<https://www.monitor.al/transformi-digjital-i-bizneseve-skema-me-e-re-e-financimit-nga-agjencia-shqiptare-e-zhvillimit-te-investimeve/>

4.5. EXPO 2020 DUBAI

• Shqipëria në Expo 2020 Dubai

Shqipëria ishte pjesë e panairit botëror Expo 2020 Dubai, me një pavijon të dedikuar me titull "Albania a Timeless Trip", së bashku me 192 shtete pjesëmarrëse, për një periudhë 6-mujore, nga 1 tetor 2021, deri më 31 mars 2022.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), kishte rolin e institucionit koordinues për organizimin e pavijonit të vendosur në zonën e Lëvizshmërisë "Mobility", një nga zonat kyçe të Expo-s. Pavijoni i Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, kishte në fokus krijimin dhe prezantimin e urave lidhëse fizike dhe virtuale produktive për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.

Një nga objektivat kryesorë ishte edhe promovimi i Shqipërisë si një partner i besuar tregtar dhe i investimeve të huaja në një sërë sektorësh të rëndësishëm për vendin si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia, etj.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai kulmoi me Ditën Kombëtare më datë 9 mars, ku Shqipëria ishte në qendër të organizimeve, gjatë se cilës u mbajtën performanca të ndryshme kulturore.

Ky panair shërbeu si një mundësi e rëndësishme për promovimin e Shqipërisë si një destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, duke shpalosur bukuritë e vendit tonë, kulturën dhe traditën e pasur shqiptare.

Pavijoni i Shqipërisë në Expo 2020 Dubai ishte simbol i identitetit kombëtar, duke pasqyruar një Shqipëri me ngjyra, të re dhe dinamike.

Pavijoni i Shqipërisë u vizitua deri më 31 mars 2022, nga mbi 430 mijë vizitorë.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Janar – Mars 2022

- **“Taste Albania”, Dubai**

Në datë 26 Shkurt 2022, AIDA në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), në kuadër të Javës së Ushqimit, Bujqësisë dhe Jetesës, në Expo 2020 Dubai, organizuan eventin “Taste Albania” në Dubai. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishte një delegacion biznesi i përbërë nga 19 kompani shqiptare, si edhe kompani të huaja, dhoma tregtie dhe organizata biznesi nga shtete të ndryshme. Gjatë aktivitetit përfaqësues të bizneseve shqiptare zhvilluan takime B2B, me synim ndarjen e eksperiencave, gjetjen e zgjidhjeve inovative dhe krijimin e mundësive të bashkëpunimit në industrinë e përpunimit të produkteve ushqimore.

- **Ceremonia e Ditës Kombëtare të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai**

Më datë 9 mars 2022, u mbajt Dita Kombëtare e Shqipërisë në kuadër të pjesëmarrjes së vendit tonë në Expo 2020 Dubai. Kjo ditë e rëndësishme bëri bashkë vizitorë të pavijonit të Shqipërisë dhe miq e dashamirës të vendit tonë. Shqipëria ishte në qendër të organizimeve, ku gjatë gjithë ditës u mbajtën performanca të ndryshme kulturore.

Ditën Kombëtare e nderoi me pjesëmarrjen e tij Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama dhe një pjesë e kabinetit qeveritar.

Gjithashtu, Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në rolin edhe të Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, e vlerësoi pjesëmarrjen në këtë event mbarëbotëror me rëndësi të veçantë në marrëdhëniet ekonomike dhe investimet që priten të jetësohen në vendin tonë.

4.6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Në kuadër të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përmbushje të këtij ligji, AIDA ka publikuar Programin e Transparencës, të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të institucionit. Në përputhje me programin e transparencës, AIDA ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.aida.gov.al të gjitha kategoritë e informacionit publik pa kërkesë në menunë AIDA/ Baza Ligjore AIDA - Programi i Transparencës. Për informim dhe transparencë të palëve të interesuara, AIDA publikon gjithashtu web edhe pasqyrat financiare, buxhetin e miratuar dhe rishikimet e tij, regjistrin e parashikimeve dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve publike. Agjencia në mënyrë të vazhdueshme rishikon dhe përditëson programin e transparencës, në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.

AIDA bën monitorimin paraprak dhe konstatues në baza ditore, të përmbajtjes së çdo e-maili të ardhur në adresën zyrtare të agjencisë info@aida.gov.al. Për vitin 2022, në adresën info@aida.gov.al kanë ardhur 635 e-maile për kërkesë informacioni, të cilat pasi janë shqyrtuar dhe hartuar informacioni i nevojshëm ju është dërguar kthim-përgjigjja brenda afateve të përcaktuara të rregullores. Për të gjitha eventet dhe aktivitetet që AIDA ka organizuar ose ka marrë pjesë, janë informuar me e-maile sipërmarrjet shqiptare sipas databazës së disponueshme.

5 DREJTORIA E KOORDINIMIT

Drejtoria e Koordinimit mban dhe koordinon marrëdhëniet institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me drejtoritë e tjera të AIDA-s. Gjithashtu, kjo drejtori koordinon edhe raportimet e ndryshme të institucionit si në kuadër të performancës, ashtu edhe të raportimeve që kanë të bëjnë me angazhime në kuadër të marrëveshjeve apo nismave që Shqipëria ka në nivel rajonal apo evropian.

5.1. STRATEGJIT

5.1.1. Strategjia Kombëtare për Migracionin

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019 - 2022, AIDA është institucion leader në një pikë të planit të miratuar me VKM-në 400, datë 19.06.2019. Në kuadër të strategjisë së migracionit janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Gjatë muajit shkurt është dërguar raportimi për Strategjin e Migracionit për periudhën Korrik – Dhjetor 2021, ku është pasqyruar puna e realizuar nga AIDA për realizimin e masës së përcaktuar.
- Përgatitur dhe dërguar raportimi për Strategjin e Migracionit për periudhën Korrik – Dhjetor 2021, ku është pasqyruar puna e realizuar nga AIDA për realizimin e masave si mbështetës për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit panë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme në kuadër të raportit për Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019–2022.
- Dërguar shkresë Agjencia Kombëtare të Diasporës, për bashkëpunim dhe për vënien në dispozicion të databas-es me kontaktet e shqiptarëve në diasporë të cilët mund të jenë target grup në nivel investitorësh të mundshëm në Republikën e Shqipërisë.

5.1.2. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023

Në kuadër të Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe Planit të Veprimit, AIDA është institucion leader sëbashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në 2 pikë të planit të miratuar me VKM-në 413, datë 19.6.2019.

Në bazë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) gjendet e përfshirë në objektivin specifik “Nxitja e investimeve strategjike private”, si dhe “Tërheqja e markave të mirënjohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm”.

Gjatë viti 2022 AIDA ka raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kontributin e dhënë në realizimin e objektivave në të cilat ndodhet e përfshirë.

5.2. KONTRIBUTI NË KUADËR TË BE- SHQIPËRI

Kontribute në kuadër të BE-së. AIDA është kontribuese gjithashtu në kuadër të përafritit të legjislacionit me BE-në, kryesisht në Kapitullin “Kriteri Ekonomik” dhe Kapitullin 20 “Për politikën industriale”. Në këtë kuadër është marrë pjesë në disa takime si dhe janë kryer një sërë raportimesh:

5.2.1. Kontribut për Kapitullin “Kriteri Ekonomik”

- Pjesëmarrje në “Explanatory Screening Meeting with Albania and North Macedonia” mbi kapitullin “Kriteri Ekonomik”, me prezencë fizike në Bruksel në datë 20.09.2022;
- Takime me kryetarë të nëngrupeve dhe me disa anëtarë të GNPIE së kap. “Kriteri Ekonomik” në mjediset e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, lidhur me përgatitjet e palës shqiptare për hartimin e Prezantimeve Dypalëshe për “Kriterin Ekonomik”;
- Përgatitja, përditësimi dhe dërgimi i draftit të PKIE për kapitullin “Kriteri ekonomik”, duke përditësuar dokumentin narrativ, me dokument reference PKIE aktuale për të gjithë periudhën e vitit 2022;

- Përgatitja e prezantimit të kontributit të AIDA-s për kapitullin “Kriteri Ekonomik” në gjuhën shqip dhe anglisht sipas formatit, template të prezantimit dhe agendes së kërkuar nga shërbimet e BE-së në takimin shpjegues të shtator 2022, në lidhje me takimin bilateral me shërbimet e BE në Bruksel;
- Pjesëmarrje online në “BILATERAL MEETING WITH ALBANIA” mbi kapitullin “Kriteri Ekonomik”.

5.2.2. Kontribut për Kapitullin 20 “Ndërmjarjet dhe Politikat Industriale”

- Përgatitja, përditesimi dhe dërgimi i draftit të PKIE për kapitullin 20 “Ndërmjarjet dhe Politikat Industriale”, duke përditësuar dokumentin narrative sipas komenteve nga KN dhe ekspertet e SONECA;
- Pjesëmarrje në trajnimin mbi “Vështirësitë e përgjithshme mbi acquis dhe çështjet e negociatave në kapitullin 20” organizuar nga GIZ;
- Pjesëmarrje në trajnimin për Kapitullin 20 mbi “Parimet e politikave industriale dhe instrumentat e tyre, konkurrueshmërinë dhe politikat për NVM-të”.

5.2.3. Kontribut për Nënkomitetin e “Cështjeve Ekonomike, Financiare E Statistikat”(Ecofin)

- Pjesëmarrje në takimin bilateral raportues me delegacionin e BE-se në lidhje me kontributin e AIDA-s për shtetë të përket nënkomitetit mbi ‘Cështjet Ekonomike, Financiare e Statistikat’(Ecofin);
- Përditësim i dokumentit mbi ‘Cështjet Ekonomike, Financiare e Statistikat’(Ecofin).

5.2.4. Kontribut për Economic Reform Program (Erp)

- Pjesëmarrje në misionin e TAIEK në datat. 9-11 Nëntor, për raportim të kontributeve të dorëzuara për ERP si dhe rishikim të tyre në rast sygjërimesh nga ekspertët e BE;
- Përditësim i materialit të ERP 2023-2025 në gjuhën shqip dhe anglisht në lidhje me kontributin e AIDA-s në vijim të kërkesave dhe komenteve të BE-së;
- Raportim për delegacionin e BE mbi dokumentin e ERP sipas fushës së përgjegjësisë.

- Është dhënë kontribut në kuadër të takimit të 12-të i Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe janë caktuar përfaqësues për pjesëmarrjen në videokonferencën e datës 15 shkurt 2022
- Pjesëmarrje në takimin e GNPIE-së në datë 23.06.2022 që u zhvillua në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94/2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve të Punës për Integrimin Evropian” dhe rregullores së funksionimit të GNPIE-ve.

• Pikat kryesore të diskutimit të takimit ishin:

1. Hartimi i Progres Raportit për Shqipërinë – kontributi II-të, për vitin 2022;
2. Monitorimi i përmbushjes së rekomandimeve të shërbimeve evropiane për Shqipërinë për vitin 2021;
3. Mbi hartimin e raportimeve 3 mujore (Prill – Qershor 2022).

5.3. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Në kuadër të takimeve dhe aktivitetit të ndryshme të zhvilluara, AIDA ka kontribuar në dërgimin e informacioneve të përditësuar dhe në marrjen pjesë në takime të ndryshme.

- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Bashkëpunimit Ekonomik me Turqinë për shtetë të përket fluksit dhe stokut të investimeve në vendin tonë.
- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit pranë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Bashkëpunimit Ekonomik me Ukrainën lidhur me fluksin dhe stokun e investimeve.

Përgatitja dhe dërgimi i informacionit pranë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Bashkëpunimit Ekonomik me Moldavinë lidhur me fluksin dhe stokun e investimeve;

- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit pranë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Bashkëpunimit Ekonomik me Indinë lidhur me fluksin dhe stokun e investimeve;

- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit panë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të Bashkëpunimit Ekonomik me Zvicrën përse i përket fluksit dhe stokut të investimeve në vendin tonë.
- Nisur procedura për riaktivizimin e sistemit të informacionit e-invest
- Takim me përfaqësuesen e Departamentit të Ndërmarrësisë, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Kosovë, Znj. Valmira Sejdiu mbi zhvillimin e instrumenteve për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, sfidat dhe përvojat rreth sipërmarrjeve, si edhe nisma bashkëpunese për tu ndërmarrë në të ardhmen.
- Bashkëpunim me GIZ mbi Planin e Veprimit të programit ProSEED 02 PSD. Programi ka katër objektivat kryesore ku një rol të rëndësishëm në realizimin e tyre luan dhe AIDA: (i) Integrimi i elementeve të gjelbër dhe dixhital në kualifikimin e të rriturve, si dhe masat e Arsimit dhe Trajnimit Teknik dhe Profesional , (ii) Rritja e konkurrencës së Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (MSME-të) duke përdorur më mirë potencialin e tyre të gjelbër dhe dixhital, (iii) Stabilizimin e punësimeve në MSME-të dhe (iv) Forcimin e kapaciteteve të ministrive dhe autoriteteve kombëtare përkatëse për zhvillimin e strategjive të punësimit.
- Bashkëpunim me GIZ dhe ekspertin e kontraktuar mbi diskutimet mbi draft Strategjinë e Eksporteve.
- Pikë kontakti me RUMMINGidea Greece mbi bashkëpunime të përbashkëta sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë për organizimin dhe pjesëmarrjen e AIDA-s në panaire, forume, aktivitete ndërkombëtare në kuadër të promovimit të produkteve "Made in Albania" dhe nxitjen e eksporteve.
- Bashkëpunim me MEPJ, Ambasadën e Shqipërisë në Greqi, Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë në lidhje me organizimin dhe pjesëmarrjen e AIDA-s në Forumin e Biznesit Greqi - Shqipëri & takime B2B, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme greke. Qëllimi i eventit ishte të informonte sipërmarrësit grekë për perspektivat dhe mundësitë që paraqet tregu shqiptar.

5.4.AKTIVITETE

- Pjesëmarrje në workshop-in me temë: "Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 të Republikës së Shqipërisë" miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 350 datë 26.05.2022 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025", organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Shqipërisë (DPPI) më datë 05.10.2022. Qëllimi i kësaj strategjie është të forcojë sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë dhe ta bëjë atë të krahasueshme me atë të Bashkimit Europian, si një mekanizëm stimulues i zhvillimit ekonomik.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga IOM me fokus: "Forcimi i Kuadrit të Migracionit për Motive Punësimi në Shqipëri". Është zhvilluar trajnim 3 ditor për zyrtarët e qeverisë shqiptare mbi "Statistikat e Migrimit të Punës në Shqipëri", me pjesëmarrës të IOM në Tiranë, INSTAT-it, ASPA-s, MB dhe MFE, AIDA etj.

Gjithashtu AIDA ka qenë pjesëmarrëse edhe në Konferencën Përmbyllëse "Forcimi i kuadrit të migrimit të punës në shqipëri" organizuar në muajin Dhjetor.

Në konferencë janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet:

1. Vlerësimi i kornizave të lëvizjes së fuqisë punëtore dhe ndikimit të tyre në lëvizjen e migrantëve shqiptarë të punës;
2. Parashikimi i popullsisë së Shqipërisë për periudhën 2021-2050;
3. Tendencat e tregut të punës, analiza e migracionit dhe rekomandime për politikë;
4. Rekrutimi etik për migrantët e punës;
5. Korniza e Migracionit të Punës dhe Udhërrëfyesi i Politikave në Shqipëri.

- **Pjesëmarrje në "Konferencën e Investimeve për Rajonin e Ballkanit Perëndimor"** që u zhvillua në Lubjanë, Slloveni më 22 nëntor 2022. Kjo konferencë u organizua nga RCC dhe Western Balkan Chamber në të morën pjesë investitorë të ndryshëm nga Slovenia, Italia, Austria, Kroacia,

prezantues nga Dhomat e Tregtisë së rajonit dhe përfaqësues nga IPA-t e rajonit me fokus në promovimin e rajonit tonë si një destinacion për sektorin e investimeve. Në panelin diskutues, ku bëri pjesë AIDA së bashku me përfaqësues të tjerë të rajonit nga Kosova, Bosnja dhe Mal i Zi, u diskutua mbi çështjet kryesore të zhvillimit ekonomik rajonal në rrethanat aktuale globale, mbi arsyet dhe sektorët kryesore në fushën e investimeve në rajon, si edhe mbi faktin se si po reagojnë qeveritë përkatëse të BB6 ndaj mundësive që po shpalosen.

- AIDA ishte institucioni koordinues i përgatitjes dhe ndjekjes të agendës dy ditore të grupit të madh prestigjioz spanjoll të rrjetit të hotelerisë, “Barcelo Group”.
- Interesi i vizitës ishte takimi me aktorë të biznesit dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore me qëllim zgjerimin e markës/brandit të tyre në vendin tonë. Në kuadër të vizitës, u realizuan 5 takime me përfaqësues të subjekteve përfitues të statusit të investitorit strategjik në fushën e turizmit si dhe takim me Kryesiministrin dhe Ministren e Turizmit dhe Mjedisit.
- **Pjesëmarrje në takimin virtual me “Enterprise Greece”.** Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Greqi në fushën e investimeve dhe eksporteve, si dhe rolit të diplomacisë ekonomike, nën koordinimin e Ambasadës së RSH-së Athinë u realizua takimi i parë paraprak, në formë virtuale, midis përfaqësuesve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe homologes greke Enterprise Greece. Përfaqësitë e dy Agjencive, shkëmbyen në mënyrë interaktive përvojën rreth aktivitetit të institucioneve të tyre si dhe diskutuan mbi mundësitë e bashkëpunimit afatshkurtër dhe afatgjatë, shkëmbimit të njohurive, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta etj.

- Plotësimin e pyetësorit të Sekretariatit të Organizatës Botërore të Tregtisë për Raportin për Rishikimin e Tretë të Politikave Tregtare (TPR) të Shqipërisë;
- Plotësimin e pyetësorit lidhur me transferimin e teknologjisë dhe zhvillimit të aftësive në Shqipëri;
- “Trade Review”, për periudhën mesi i muajit maj 2022 - mesi i muajit tetor 2022, për politikat tregtare të vendeve lidhur me të gjitha masat tregtare dhe të lidhura me tregtinë, si dhe masat e marra posaçërisht në kontekstin e pandemisë COVID-19.

5.5.RAPORTIME

- Gjenerimi i informacionit, koordinimi i tij midis sektorëve të AIDA-s dhe përgatitja e Raporteve Mujore për periudhën Janar- Dhjetor 2022;
- Përgatitja e Raportit Vjetor;
- Raportim për matjen e performancës dhe rezultateve;

6 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

6.1.MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE


Referuar nevojave të AIDA-s për burime njerëzore gjatë vitit 2022 janë ndjekur procedurat e rekrutimit për vendet vakante, me qëllim realizimin e këtij procesi duke ju përmbajtur përcaktimeve ligjore, kritereve dhe specifikave për secilin pozicion vakant, në zbatim të ligjit nr. Ligjin 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nismës “Gati për Shqipërinë”, për vitin 2022.

Konkretisht janë realizuar 5 rekrutime të reja (2 në nivel drejtor drejtorie dhe 3 në nivel specialisti). Gjithashtu është punësuar dhe 1(një) student ekselence në kuadër të nismës “Gati për Shqipëri”.

6.2.PERFORMANCA FINANCIARE

AIDA në zbatim të funksioneve të veta si dhe në zbatim të VKM nr. 375, datë 01.06.2022 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr.25/2022, Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” ka menaxhuar procesin e disbursimit të Fondit “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”. Procedura e disbursimit është realizuar në bazë të VKM nr. 480, datë 13.07.2022 “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve.”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave dhe dosjeve për disbursim të përcjella nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Buxheti i alokuar për këtë fond ishte 300,000,000 lekë, duke rezultuar me një fakt realizimi prej 274,543,706 lekë në përfundim të procesit. Nga kjo mbështetje financiare përfituan 29 lehësuese dhe 29 përfituesit.

■ Fondi akomoduar për mbështetjen e startup-eve
■ Fondi i startup-eve




6.2.PERFORMANCA FINANCIARE

- Hartimi dhe detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente 600, 601, 602 dhe 606, në funksion të përmbushjes së objektivave të AIDA-s. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit dhe më tej është rishikuar gjatë vitit për shkak të nevojave të lindura në kuadër të realizimit të detyrave funksionale të institucionit.
- Gjatë vitit 2022, me ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, në përshtatje të kushteve të reja, u realizuan shpenzimet korrente dhe kapitale, siç paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Fondi për paga dhe sigurime u realizua përkatësisht në masën 100%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 91%. Shpenzimet për transferata individësh u realizuan në masën 91%. Ndërsa fondi i investimeve kapitale të brendshme u realizua në masën 16%.

Realizimi i buxhetit 2022



ANEKS 1
PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Nr.	Subjekti Aplikues/ Emri i Projektit	Sektori	Vlera/ Punësimi	Afati i realizimit	Përshkrimi	Vendndodhja	Pronësia	Procedura	Status Aktual
1	MANE TCI "New Born"	Turizëm	€ 26,000,000 250 vende pune	13.03.2020	Kompleks turistik në S=187,000 m2.	Bashkia Durrës	Privat	Procedurë Asistuar VKIS Nr. 1/15 datë 14.7.2016	Është realizuar afërsisht 95% e investimit.
2	GREEN COAST "Green Coast 1"	Turizëm	€ 52,500,000 250 vende pune	27.04.2021	Kompleks turistik në S=183,500 m2	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e Veçantë VKIS Nr. 2/13 datë 14.7.2016	Është realizuar mbi 50% e investimit
3	ALB PANEL NGR "Albpanel"	Bujqësi Industriale	€ 15,000,000 300 vende pune	38 muaj nga data e fillimit pasi investimi nuk ka filluar ende	Projekti synon të përdorë lende të parë kallamin dhe të prodhojë si produkt final panele MDE	Libofshe (Fier) dhe Rremas, (Lushnjë)	Shtet	Procedurë e Asistuar VKIS Nr. 7/1, datë 5.12.2016	Janar 2020, KIS miratoi një ndryshim në vendimin për Albpanel për ndryshim zone. Vendim KIS NR. 7/5 , datë 7.1.2020
4	AGROCON ALBANIA "Agrocon"	Bujqësi	€ 5,832,000 120 vende pune	26.01.2019	Ferme Bujqësore në S=30 Ha	Bashkia Lushnjë	Shtet	Procedurë e Asistuar VKIS Nr. 21/2 datë 20.12.2017	Është realizuar afërsisht 95% e investimit.

5	CONCORD INVESTMENT "Gone Perivol"	Turizëm	€ 32,500,000 200 vende pune	12.04.2022	Kompleks Turistik	Bashkia Himare	Privat	Procedurë e Asistuar miratuar me Vendim të KIS nr. 24/2, date 20.11.2017. Shtyrë afati i vlefshmërisë së statusit me VKIS nr. 24/7 datë 29.3.2021	Është realizuar afërsisht 20% e investimit.
6	CONCORD INVESTMENT "San Pietro"	Turizëm	€ 88,000,000 250 vende pune	05.05.2020	Kompleks Turistik	Bashkia Durrës	Privat	Procedurë e Veçantë VKIS nr.25/2 datë 20.12.2017	Është realizuar afërsisht 60% e investimit. Me vendim të KIS nr. 25/5 datë 15.12.2020, është bërë shtyrja e afatit të Statusit për një periudhë 2 vjeçare.
7	BOIKEN SHPK "Kepi Merli"	Turizëm	€ 78,000,000 263 vende pune		Eko Resort	Bashkia Sarandë	Shtet (Subjekti person i stimuluar)	Subjekti ka aplikuar për Procedurë e Asistuar. Me Vendim të KIS Nr. 23/2, datë 20.11.2017 u vendos se duhet pritur vendimi i KKT.	Projekti në proces zbatimi

8	XH&M CO "Delta Bay"	Turizëm	€ 22,700,000 107 vende pune		Kompleks Turistik	Bashkia Himare	Privat	Subjekti ka aplikuar për Procedurë e Asistuar. Me Vendim të KIS Nr. 23/2, datë 20.11.2017 u vendos se duhet pritur vendimi i KKT.	Subjekti nuk ri ka aplikuar tek AIDA
9	STAR TEK "Dhërmi"	Turizëm	€ 12,140,000 300 vende pune		Resort Turistik	Bashkia Dhërmi	Shtet	Procedurë e Asistuar. VKIS nr. 2/3 datë 02.09.2019	Projekti fillon zbatimin pasi te behet regjistrimi filleshtar i zonës
10	GPP KORÇA	Energji (TEC Korça)	€ 349,700,000 123 vende pune	3 vite nga data e fillimit te investimit.	HEC Korça	Bashkia Korçë	Shtet	Procedure e veçantë VKIS Nr.30/4, datë 14.02.2018	Subjektit i është refuzuar Deklarata Mjedisore nga MTM.
11	EUROCOL "White Rocks"	Turizëm	€ 6,800,000 81 vende pune	3 vite nga fillimi	Resort Turistik	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr.15/3, datë 04.03.2019.	Projekti në proces zbatimi

12	AQUATIQ Akuaponi – hidroponi	Bujqësi	€ 5,1 mln 50 vende pune	6 muaj nga data e fillimit te investimit	Akuaponi – hidroponi	Bashkia Divjakë	Shtet	Procedurë e asistuar VKIS nr.4/4, datë 19.04.2018	Subjektit ka riaplikuar për një sipërfaqe më të madhe, në të njëjtën zonë ku është miratuar edhe ndryshimi potencial për Albpanel.
13	AGROILIRIA "Planatacion shege, avokado, finger lime...."	Bujqësi	€ 6,627 mln 115 vende pune	5 vite nga data e fillimit.	Planatacion shege, avokado, finger lime....	Bashkia Divjake	Shtet	Procedurë e asistuar VKIS nr. 6/4, datë 19.04.2018 Ndryshuar me VKIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020	Në proces nënshkrimi i MGF ndërmjet MFE dhe subjektit. Me VKIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020 u miratua zëvendësimi i kulturave me kivi, rrush, dardhë etj,, si dhe zhvillimi i agroturizimit, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë. Investimi ka filluar vetëm në 87 ha tokë.

14	YURA COPERATION ALBANIA "Fabrikë për prodhimin e sistemeve dhe pjesëve elektrike për automobilë"	Industri Automotiv e (Zonë me përparësi zhvillimi)	€ 6.459.000	2 vite	Fabrike për prodhimin e pjesëve automotive	Bashkia Fier	Shtet	Procedure e asistuar VKIS nr. 14/3 datë 12.02.2019	Projekti në proces zbatimi
15	SOLEIL & SEA "Jala Entertainment Park "	Turizëm	€ 67,000,000 620 vende pune	3 vite	Resort Turistik	Bashkia Himarë	Privat dhe Shtet	Procedurë e veçantë VKIS nr. 20/5, datë 01.08.2019	Projekti ne proces zbatimi. Është pezulluar një pjesë e projektit për shkak të çështjeve të pronësisë.
16	LAJTHIZA INVEST SH.A "Kompleks Turizëm Rural Lajthiza	Turizëm	€ 20,000,000 200 vende pune	Dhjeto r 2022	Hotel modern, si dhe një fabrikë të re të ambalazhimit të ujit të pijshëm në shishe.	Bashkia Fushë – Arrëz	Shtet	Procedurë e asistuar VKIS Nr. 36/6, datë 24.06.2020	Projekti është në proces
17	SHIDDI GROUP SH.P.K DHE AL SHIDDI TRADING COMPANY LTD "Tirana City Center"	Turizëm	106,850,000 1500 vende pune	Brend a 6 viteve	Ndërtimi i një investimi kompleks dhe i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare	Bashkia Tiranë	Shtet	Procedurë e veçantë VKIS Nr. 2/7, datë 27/07/2020	Duke u vlerësuar përmbushja nga subjekti investues i kriterit financiar duke dëshmuar disponimin e kapacitetit financiar në vlerën prej

					turistike-hotel, apartamente elitare hotel, vila elitare Sky Village, strukturë mbështetëse turistike-qendër tregtare dhe garazh nëntokësor ashtu si dhe ndërtesë për zyra.				20% të vlerës totale të investimit si dhe plotësimin e kushteve paraprake. Parakushtet e vendosura me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7, datë 27.07.2020, konsiderohen të plotësuara nga ana e subjektit
18	GREEN COAST SHPK "Green Coast 1"	Turizëm	€ 125,400,000 800 vende pune	36 muaj	Ndërtimi i 2 (dy) strukturave akomoduese turistike, hotel 5 yje, si dhe kompleks turistik.	Bashkia Himarë	Privat dhe Shtet	Procedurë e veçantë VKIS nr. 8/5 datë 15.12.2020	Projekt ka përfituar status strategjik me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/13, datë 14/07/2016, me afat 4 (katër) vjeçar. Subjekti është pajisur me Leje Zhvillimore Komplekse Nr. Prot 2385/2 datë 27.04.2015, lëshuar sipas Vendimit Nr.8, datë 07.03.2014, miratuar nga KKT, e përditësuar me Lejen e Ndërtimit sipas Vendimit Nr.13. datë 12.04.2017, për "Rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese dhe shtesë në sipërfaqe të Resortit Turistik "Green Coast", me adresë në Palasë, Bashkia Himarë", miratuar nga KKT.

19	BASHKIA TIRANË	Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit	€ 102,666,431	Brenda 1 viti nga vendimi KIS Bashkia duhet të aplikojë për marrjen e statusit final strategjik	Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja dhe teknologjive të informacionit, hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës duke futur industri qëpërbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë.	Bashkia Tiranë	Privat dhe Shtet	TEDA VKIS Nr. 1/4, datë 04.05.2020	Projekti në proces zbatimi
			€ 62,000,000 5000-7000 vende pune	4 vjet	Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja dhe teknologjive të informacionit, hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës duke futur industri qëpërbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë.	Bashkia Tiranë	Privat dhe Shtet	TEDA Miratuar statusi përfundimt ar me VKIS nr. 1/8 datë 15.7.2021	
20	ILIR TREBICKA "Hotel Chaonians Deluxe"	Turizëm	€ 5,500,000 90 vende pune	2 vjet	Ndërtim i një hoteli me 4 yje, si pjesë e kompleksit turistik të quajtur "Thymus", i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 0.33 ha, të ndodhur në zonën kadastrale 1739, në fshatin Dhërmi, Himarë.	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr. 14/6 datë 4.2.2021	Projekti ende nuk ka filluar.

21	"MARSEGLIA GREEN ENERGY" SH.P.K. MARSEGLIA GROUP SpA "Parku me erë"	Energji	€ 244,000,000 350 vende pune	18 muaj	Ndërtimi i dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 MW dhe do të zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 HA, në vargmalet e Rencit dhe Kakariqit, të vendosura paralel me vijën bregdetare në Shëngjin dhe Balldren, Lezhë.	Bashkia Lezhë	Shtet	Procedurë e veçantë VKIS nr. 11/6 datë 4.2.2021 Ndryshuar me: VKIS nr. 11/13 datë 18.7.2022	Projekti ende nuk ka filluar.
22	COAST TO COAST SH.P.K. GJIKURIA SH.P.K. "Coast to Coast"	Turizëm	€ 56,910,000 150 vende pune	6 vjet	Investimi kompleks i përbërë nga 3 hotele dhe vila rezidenciale me sipërfaqe truall 20.9 ha në zonën kadastrale 1739, në fshatin Gajtjanitika dhe Perivolo, Himarë.	Bashkia Himarë	Shtet dhe privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 10/8 datë 4.2.2021	Projekti nuk ka nisur ende. Zona kadastrale 1739, nuk është e menaxhuar dhe për pasojë nuk është bërë regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, çka vështirëson punën për evidentimin e pronarëve dhe të problematikave që mund të ketë.

23	GREEN COAST SH.P.K. "Green Coast 2"	Turizëm	€ 60,800,000 720 vende pune	6 vite	Green Coast 2: Ndërtimi i 5 hoteleve me 100 dhoma secili, vila individuale elitë, apartamente, pishina, restorante, bar-kafe, qendër shëndetësore, palestër dhe një park publik.	Bashkia Himarë	Shtet dhe privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 12/1 datë 4.2.2021	
24	DELTA SH.A. "Delta Falaise Resort & Village Faza 1"	Turizëm	€ 51,267,942 243 vende pune	4 vjet	Faza 1 parashikon ndërtimin e një Resorti me 5 yje, që do të përbëhet nga 1 ndërtesë 3 katëshe me një lartësi maksimale prej 12 metrash dhe një kapacitet prej 440 dhomash, i cili do të ofrojë shërbime cilësore e me standarde të larta në fushën e turizmit dhe mikpritjes.	Bashkia Himarë	Shtet dhe privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 15/6 datë 4.2.2021	Projekti nuk ka nisur ende
25	AG.TCC SH.P.K. "Dreamades Luxury Suites"	Turizëm	€ 5,556,192 120 vende pune	3 vjet	Projekti parashikon realizimin e zhvillimit të një investimi kompleks, të përbërë nga një Hotel me 5*, i nivelit të lartë, i konceptuar në disa kate me tarraca dhe do të ketë një kapacitet prej 106 suita.	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr. 3/5 datë 29.3.2021 Ndryshuar me VKIS nr. 3/9 datë 15.7.2021	Projekti ende nuk ka filluar.

26	JONIAN HEAVEN GROUP SH.P.K. "Jonaian Heaven"	Turizëm	€ 78,365,976 819 vende pune	Brenda 1 viti nga vendimi, subjekti aplikues duhet të aplikojë për marrjen e statusit final strategjik	Projekti konsiston në ndërtimin e një kompleksi turistik, me 636 ambinete akomodimi restorante, bare, një kazino, salla konferencash, pishinë, SPA etj.	Bashkia Konispol	Shtet dhe privat	Projekt me potencial strategjik VKIS nr. 9/8 datë 4.2.2021	Subjekti ka fituar statusin "projekt me potencial strategjik". Projekti do të fillojë pasi subjekti të pajiset me statusin përfundimtar të investimit/investitorit strategjik.
27	"MARINA DI VALONA" SH.P.K, "BRUNES" SH.P.K, "NDREGJONI" SH.P.K. DHE "MARINA PROJECTS" L.T.D "Marina di Valona"	Turizëm	€ 105,000,000 1000 vende pune	6 vjet	Projekt i integruar i cili konsiston në zhvillimin e një infrastrukture koncensionare portuale turistike si dhe zhvillimin e njësive akomoduese, hoteleri e shërbime të standardizuara të zonës në kufi me infrastrukturën portuale.	Bashkia Vlorë	Shtet dhe privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 4/3 datë 29.3.2021	Projekt ende nuk ka filluar.
28	BLUE BAY SH.P.K. "Drymades Beach Resort"	Turizëm	€ 6,326,000 165 vende pune	3 vjet	Projekti parashikon ndërtimin e 1 hoteli elitare të standardit 5 yje me 110 hapësira akomoduese.	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr. 7/6 datë 15.7.2021	Projekti është i pajisur me Vendim të KKT Nr. 16 datë 26.01.2021 për miratim leje zhvillimi.

29	DAST SH.A. "Banyan Tree Hotel Resort"	Turizëm	€ 24,184,990 184 vende pune	2 vjet	Resort me disa kate me taraca me kapacitet 184 dhoma (standarde, duplex, suita dhe vila) si dhe do të ofrojë restorante, bare, pishina, SPA, palestër, salla konferencash, zona të dedikuara për fëmijët, parking dhe shumë mjedise të tjera çlodhëse e rekreative që do të plotësojnë të gjitha standardet në fuqi për certifikimin si "Hotel me 5 yje.	Bashkia Himarë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr. 1/5 datë 29.3.2021	Projekti nuk ka filluar ende.
30	PREMIUM FINANCE INVEST SH.P.K. "Cape of Rodon, Faza 1"	Turizëm	€ 51,369.455 200 vende pune	7 vjet	Projekti parashikon realizimin e një projekti kompleks. Faza e parë do të përfshijë realizimin e: • një hoteli me 4* me sipërfaqe 26,150 m2 do të ketë 250 dhoma si dhe shërbime në funksion të tij; • 30 vila me sipërfaqe totale prej 16,200 m2;; • një kantinë vere me sipërfaqe prej 2,000 m2; • një park ujor me sipërfaqe 500m2 me një kapacitet prej 500 personash.	Bashkia Durrës	Privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 6/5 datë 15.7.2021	Projekt ende nuk ka filluar.

31	"AQUATIQ" SH.P.K. "Fermë akuaponi"	Bujqësi	€ 26,000,000 1500 vende pune	15 muaj	Projekti parashikon ndërtimin e një Ferme Akuaponike, me një sistem me dy nivele: • një rezervuar me peshq, si bazament i impiantit; dhe • sera ku do të rriten perimet mbi të.	Bashkia Divjakë	Shtet	Procedurë e asistuar VKIS nr. 3/8 datë 15.7.2021 VKIS nr. 3/12, datë 5.4.2022 "Për mospranimin e kërkesës së subjektit investues, shoqërisë "Aquatiq" sh.p.k. për korrigjimin e një gabimi material në zbardhjen e Vendimit nr. 3/8 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike "për miratimin e statusit të investitorit strategjik për realizimin e "Fermës Akuaponike".	• Ky është aplikimi i dytë i subjektit "Aquatiq" sh.p.k., pas atij të vitit 2018, i cili, me Vendim të KIS nr. 4/4, datë 19.04.2018, përfitoi statusin strategjik për një hapësirë prej vetëm 1.3 ha, në Karavasta të Re, në zonën DJ_B_EB_2, duke u vlerësuar pozitivisht, si projekt pilot. • Vendimi i KIS Nr. 4/4, datë 19.04.2018 nuk u vu në zbatim nga subjekti, pasi projekti u konsiderua si një investim, që do të rritej dhe se zona në fjalë, potencialisht, nuk do ta lejonte zgjerimin e këtij aktiviteti, ndaj dhe subjekti ri-aplikoi në vitin 2020 për një hapësirë tjetër më të madhe, prej 146 ha, për realizimin e këtij investimi. Projekti nuk ka filluar ende.
32	IMPERIAL GROUP SH.P.K. "Silver Sand Resort"	Turizëm	€ 52,000,000 80 vende pune	5 vjet	Projekti parashikon realizimin e një kompleksi turistik.	Bashkia Shkodër	Privat	Procedurë e veçantë VKIS nr. 19/6 datë 15.7.2021	Projekti nuk ka filluar ende.

33	DELTA SH.A. "Delta Falaise Resort & Village Faza 2, 3, 4, 5"	Turizëm	€ 154,964,433 200 vende pune	15 muaj	Faza 2, 3, 4, 5 parashikon ndërtimin e vilave individuale rezidenciale, 1 hotel me 5* dhe 245 dhoma, Vila rezidenciale, apartamente, njësi shërbimi, ambiente rekreative.	Bashkia Himarë	Privat dhe Shtet	Procedurë e veçantë VKIS nr. 15/13 datë 15.7.2021	Projekti nuk ka filluar ende.
34	ALB STAR SH.P.K. "Manastir Resort"	Turizëm	€ 28,000,000 180 vende pune	4 vjet	Projekti parashikon ndërtimin e një resorti, që do të ketë në përbërje hotel dhe struktura akomoduese me rreth 33 njësi të ndara me kapacitet total që variojnë nga 83-100 shtretër, restorant, bar, pishinë e jashtme etj	Bashkia Sarandë	Privat	Procedurë e asistuar VKIS nr. 8/6 datë 2.12.2021	• Projekti është i pajisur me Vendim të KKT Nr. 28, datë 28.12.2020, "Për miratim e lejes së zhvillimit për objektin "Resort Turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Sarandë. • Projekti është i pajisur me leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 9, datë 10.06.2021 "Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Resort Turistik 2, 3 dhe 4 me parkime nëntokë" me vendndodhje në Bashkinë Sarandë".

35	MEDITERRANEA N WAVE SH.P.K. "Mediterranean Wave"	Turizëm	€ 50,409,836 80 vende pune	5 vjet	Projekti parashikon ndërtimin e një Kompleksi Turistik.	Bashkia Kavajë	Shtet	Procedurë e veçantë VKIS nr. 11/9 datë 2.12.2021	Projekti nuk ka filluar ende.
36	"EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT" SH.P.K.	Turizëm Infrastruk turë	€ 2,000,000,0 00 12,000 vende pune	12 vjet	Projekti i integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre.	Bashkia Durrës	Shtet dhe privat	VKIS nr. 14/6 datë 2.12.2021 Ndryshuar me: VKIS nr. 14/45 datë 18.7.2022 VKIS nr. 14/61 datë 27.10.2022	Projekti nuk ka filluar ende.
37	"FINSEC DEVELOPMENT" SH.P.K, "MARINA HILLS"	Turizëm	€ 450,000,00 0 200 vende pune	10 vjet	Projektit do të zhvillohet me një përzierje të përbërësve të banimit duke përfshirë vila, apartamente të tipologjive të ndryshme, hoteleri, homestead, azil, hipizëm, beach bars, fushë golfi, etj.	Bashkia Kavajë	Shtet	VKIS nr. 10/15 datë 5.4.2022	Projekti nuk ka filluar ende.

38	"WHITE ROADS HOTEL" SH.P.K. "White Roads Hotel"	Turizëm	€ 10.000.000 100 vende pune	4 vjet	Projekti parashikon ndërtimin e strukturave akomoduese (hoteli me 5 yje), me shumëllojshmëri ambjentesh pushimi dhe akomodimi në dispozicion të pushuesve.	Bashkia Himarë	Shtet dhe privat	VKIS nr. 1/6 datë 5.4.2022	Projekti nuk ka filluar ende.
39	-	-	-	-	-	Bashkia Divjakë	Shtet	VKIS nr. 17 datë 18.7.2022	Për transferimin e parcelave të lira, pronë shtetërore, në zonën Dj-B_B_1, në Zonën Kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.
40	"OMNIX ALBANIA" SH.P.K.	Turizëm	€ 216,000,000 252 vende pune	5 vjet	Resort me struktura akomoduese me një sërë funksionesh.	Bashkia Durrës	Shtet dhe privat	VKIS nr. 22/9 datë 18.7.2022	Projekti nuk ka filluar ende.
41	"ZAGROTURIZË" SH.P.K	Agro-turizëm	€ 5,457,335	2 vjet	Investim në fushën e hotelerisë dhe mikpritjes duke ofruar shërbime mikse në fushën e agroturizmit dhe turizmit malor me standarde të larta shërbimi për klientët.	Bashkia Tepelenë	Shtet	VKIS nr. 17/5 datë 18.7.2022	Projekti nuk ka filluar ende.

PROJEKTE INVESTIMI TË MOS PRANUARA

1	ADRIATICA HOLDING SHPK "Kultivimi i karakalecave"	Bujqësi / akuakulturë	€ 4,200,000 120 vende pune	Kultivimi i karkalecave	Bashkia Divjakë	Shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me VKIS Nr. 1/3, datë 19.04.2018	Projekti nuk u miratua, pasi bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, atij për zonat e mbrojtura, legjislacionit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, specia e përdorur në kultivim është e ndaluar në Evropë, si një specie invazive që shkakton zhdukjen e specieve autoktone.
2	SOUTH COAST DEVELOPMENT "Krorëz Resort"	Turizëm	€ 110,000,000 600 vende pune.	Turizëm Hotel + Vila	Bashkia Himarë	Shtet dhe privat	Procedurë e veçantë Refuzuar me VKIS nr. 13/5 datë 4.03.2019	Projekti nuk u miratua, pasi subjekti nuk përmbushte kapacitetet financiare të kërkuara sipas ligjit.
3	"NOVOSELE PHOTOVOLT AIC POWER PLANT" "Impiant Fotovoltaik Energjitik 50 MWAC"	Energji	€ 84.782.706 Punësimi 503-784 vende	Impiant gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike	Bashkia Vlorë	Shtet	Procedurë e veçantë Refuzuar me VKISNr. 34/2, datë 14.02.2018	Projekti nuk u pranua, pasi ai është në mospërputhje me destinacionin e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor Vlorë, pasi në këtë zonë parashikohet ndërtimi i një aeroporti. Subjekti nuk disponon një autorizim paraprak të vlefshëm, për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmërisë 6 mujore të Autorizimit Paraprak (për vazhdim procedure) nga MEI. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar nga ligji, brenda afateve të autorizimit paraprak, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, duke humbur automatikisht të drejtën e fituar në përfundim të afateve të përcaktuara në miratimin paraprak.

4	"Mane TCI" SH.P.K. "Vala Mare II"	Turizëm	€ 64,162,910 200 vende pune	Struktura turistike, vila dhe apartamente	Bashkia Durrës	Privat	Procedurë e veçantë Refuzuar me VKIS Nr. 22/2, datë 20.11.2017	Projekti nuk u pranua, pasi strukturat akomoduese turistike të projektit nuk janë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të turizmit në fuqi.
5	"CONCORD INVESTMENT" SH.P.K. "Saranda Marina Resort & Senior Housing"	Turizëm	€ 26,125,000 -	Kompleks turistik	Bashkia Sarandë	Shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me VKIS Nr. 26/2, date 20/11/2017	Projekti nuk u pranua, pasivlerësohet i pamaturuar. Plani zhvillimor i projektit shtrihet në ZK Nr. 8642 Sarandë dhe përfshin zonën e ish – Repartit Ushtarak në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes, zonën e portit të peshkimit dhe zonën e kalatës tregtare të Portit të Sarandës në pronësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky projekt investimi është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë. Kriteret teknike të PPV Sarandë parashikojnë që destinacioni i zonës është rekreacioni/rigjenerimi urban, dhe jo banim e resort që do ta kthenin zonën në territor privat me përdorim të kufizuar.
6	"MILLENIUM INTERNATIONAL" SH.P.K. "Poro Vlorë"	Turizëm	€ 21,081,700 148 vende pune	Kompleks turistik	Bashkia Vlorë	Privat + shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me VKIS Nr. 10/3, datë 05/12/2016	Projekti nuk u pranua, për shkaqe që lidhen me verifikimin e kushteve të ardhshme, pasi legjislacioni i ri për zonat e mbrojtura, i cili do të rregullojë funksionimin e sistemit të zonimeve të brendshme për zhvillimin e turizmit, është në proces hartimi.

7	"MABETEX GROUP" SH.P.K. "Divjaka Resort Albania"	-	-	-	Bashkia Divjakë	Shtet	Procedurë e veçantë Refuzuar me VKIS Nr. 16/3 , datë 4.3.2019	Projekti nuk u pranua pasi tipologjia e projektit nuk është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe atë për zonat e mbrojtura, pasi projekti synon të shtrihet brenda Parkut Kombëtar Divjaka- Karavasta dhe prek Zonë Qendrore, Zonë Kreative dhe Zonë të Përdorimit Tradicional.
8	"ADRIATICA HOLDING" SHPK "Kultivimi i karakalecave"	Bujqësi / akuakulturë	€ 4,000,000 120 vende pune	Kultivimi i karkalecave	Bashkia Divjakë	Shtet	Procedure e asistuar Refuzuar me Vendim KIS Nr. 18/5, date 01.08.2019	Projekti nuk u pranua, pasi, në referencë të legjislacionit për zonat e mbrojtura, legjislacionit për mbrojtjen e biodiversitetit, legjislacionit për zhvillimin e akuakulturës, specia e kërkuar për t'u përdorur për kultivim është specie invazive dhe tipologjia e projektit nuk përputhet me kriteret e zonës. Subjekti propozues paraqet mungesë të burimeve dhe kapaciteteve financiare, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
9	"VORTEK" SH.P.K & "BEST DUTY FREE" SH.P.K. "Beryl Resort"	Turizëm	€ 15.519.970 165 vende pune	1 hotel me 4 yje dhe njësi akomoduese vila dhe apartamente, si dhe ambiente shërbimi, si bare dhe restorante, SPA etj.	Fshati Qerret, Bashkia Kavajë	Shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me Vendim KIS / dhjetor 2020	Projekti nuk u pranua, pasi, referuar 'Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit' si dhe dokumenteve të tjerë në fuqi për planifikimin dhe rregullimin e territorit, modeli i propozuar i projektit të investimit "Beryl" nuk përputhet me modelin e miratuar në këto akte për një zhvillim cilësor të industrisë së turizmit në përputhje me treguesit që zonat me përparësi zhvillim turizmi (ZPZHT) parashikojnë.

10	"JONIAN HEAVEN GROUP" SH.P.K. "Jonian Heaven"	Turizëm	€ 78,000,000 443 vende pune	Dy hotele respektivisht, me 280 dhoma dhe 84 dhoma, restorante, bare, një kazino, salla konferencash, pishinë, SPA.	Fshati Vrinë, Bashkia Konispol	Privat dhe shtet	Projekt me potencial strategjik Refuzuar me Vendim KIS / dhjetor 2020	Projekti nuk u pranua, pasi, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, projekt propozimi është jo i plotë, i pamundur të klasifikohet si "projekt me potencial strategjik" e të konsiderohet një projekt i mundshëm investimi me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, në kuptim të parashikimeve të VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015 "Për miratimin e projekteve me statusin "Projekt me Potencial Strategjik".
11	"VORTEK" SH.P.K. & "BEST DUTY FREE" SH.P.K. "Beryl Resort"	Turizëm	€ 15.519.970 165 vende pune	Hotel me 4 Yje, njësi akomoduese, etj.	Bashkia Kavajë	Privat dhe shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me VKIS nr. 7/16 datë 15.7.2021	Projekti nuk u pranua, pasi sipërfaqja ku synohet të shtrihet, është e llojit "pyll" dhe këto pasuri duhet t'i nënshtrohen procedurës së heqjes nga "fondi pyjor" dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit. Miratimi i këtij projekti kërkon ndryshime përkatëse të parametrave të zhvillimit të zonës, kompetencë e KKT dhe, në këtë këndvështrim, projekti nuk është ende i maturuar.
12	"FAFA RESORT" SHPK	Turizëm	63,126,676 Euro 550 vende pune	Resort turistik, me një hotel me njëmbëdhjetë kate, katër godina apartamentesh dhe pesë vila individuale me një kapacitet total prej 519 dhomash	Fshati Qerret, Bashkia Kavajë	Privat dhe shtet	-	Refuzuar me VKIS nr. 21/7 datë 18.7.2022

13	"KAMPING PA EMËR PEPOSHI KARPEN- KAVAJË" SH.P.K.	Agro- Turizëm	5,223,868 euro 81 vende pune	Ndërtimi i një agroturizmi, kamping me vila druri dhe vende për kampera e tenda, serë, shërbim tregu fruta -perime nga produkte të zonës	Guri Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë	Privat dhe shtet	-	Refuzuar me VKIS nr. 2/8 datë 18.7.2022
----	---	------------------	---	--	---	------------------------	---	---